

HEJZA



Sibel HALIMI

**POEZIA, MANIFEST ESTETIK QË
NDËRGJEGJËSON NJERIUN**

Nga këndi im

SHKRIMTARI, SI NJË KRISHT PËR T'I MBUSHUR TË TJERËT ME SHPIRTIN E TIJ

Letërsia ka dy lloj pagesash. Ose të menjëershme, me një sukses të vrullshëm si komercial, si në formë fame; ose të ngadaltë, por të përjetshëm. Sa shekuj ka Homeri? Po Eskili? Po Dante? Po Servantesi? Po Shekspiri? Po Kafka?

Artur SPANJOLLI

Mallkim dhe lumburi, këto dy ndjesi të forta provoj intensivisht nga fakti i të qenët shkrimtar. Ndjej mallkim, sepse nuk ka orë, nuk ka çast, nuk ka moment privat apo shoqëror të jetës time, kur unë mos ta provoj këtë gjendje torturuese, silitëse, këmbëngulëse, mendore natyrish, prej shkrimtarit. Me trurin gjithmonë si në ethë, mendoj, hamendësoj, shpik, krijoj, kujtoj, përkoi, lodhem, tjetërsoj, mendoj rishtas alternativat e librit që kam shkruar, të atij në procesi, apo të librit i cili nuk u ka pjellë ende, por e di, ai do të lindi nga kryet, si Athinaja nga koka e Zeusit. Bing bang-ët me embrioni temash tê mëdha, të vogla, të kota, me peshë, pa peshë, po t'i mbledhesh bashkë, në jetën e një shkrimtar, nuk e kalojnë, nuk e mbushin as edhe një orë njerëzore. Truri i shkrimtarit, krejt fërgëllues e ka mendjen veç aty. Mund te jem i sapo zgjuar, në gjumë, gati duke më zënë gjumi, mund të jem duke ngrënë, me miq në shtëpi, në punë, duke ecur, duke dëgjuar muzikë, duke folur, duke medituar, pra, paralelisht me jetën e përditshme, krejt si një mallkim fatal, brenda trurit tim, zhvillohen ngjarje, lindin ide, bien hamenjde, formulohen fraza, rebelohen fjalë, këmbëngulin tituj, bien kambana, shigjetat vetëtimash përshtkojnë këmiken e trurit, si në një përzierje krejt të çregullt, a si në një ofshamë të thellë kozmike. Në këtë magje e cila nuk shteret, nuk ndalet, nuk fle kurrrë, mbahuhen edhe veprat e ardhshme. "Ti s'ë ke mendjen kur të flas!", ma kthejnë miqtë, të afërit. "Ti ke probleme me përqendrimin!", vazhdojnë të preokupuar. "Ti je në botën têndel!", shprehen. "Po po!", i them dhe tund kokën. Ua mohoj, por e di mirë se mendja ime vërtetë në ato çaste ishte arratisur larg, larg në botën paralele të krijimit. Si dy shina të cilat nuk takohen kurrrë në jetë, kështi si krijimi, ashtu edhe bota reale e përditshme, janë dy paralele të cilët shpesh përleshen me njëra tjetrën, se kush e kush të fitojë. Brenda trurit tim nazeli, fiton gjithmonë bota krijuese. Njëri pra, është filli i jetës normale me monotoninë, hallet praktike, shpenzimet, nevojën për të fituar para, punën, sëmundjet, klimën, stinët, detyrat familjare, shqetësimet e jetës. Tjetri, është filli i krijimtarisë, i cili e ka rezidencën te zona e krijimtarisë, në tru të artistit, aty ku punon fantazia krijuese, aty ku mendimet, idetë, imazhet, përfytyrimet, intuitat dhe hamendësimet, lindin, zhvillohen, këmbëngulin, lodhen dhe ndonjëherë, mbas një pune të gjatë edhe triumfojnë. Pra, shndërrohen në libra të mirë. Jetoj pra në një botë krejt të imaginuar, e cila do të paraprije, të zëvendësojë ndoshta krejt jetën e përditshme, shpesh monotone, gri ndonjëherë edhe bajate. Pra, shkrimtar i ka jetë.

Me siguri, jeta krijuese është edhe më eksistuesja, më e gjalla, më sublimja, më hyjnorja. Ky është një mallkim i mrekullueshëm, të cilën e provojnë të gjithë krijuesit dhe sidomos shkrimtarët. E ndjej këtë trysni të fortë, më shpesh, sepse me siguri shkrimtar do të donte të ishte më i afirmuar, me më me shumë lexues, me më shumë botime, përkthime, etj. Do të dëshironë të ishte më popullor dhe më fuqipotë me veprat e tij në raport me publikun, me lexuesin. Por, historia e letërsisë e ka treguar, se shumë shpesh, vlerat e vërteta, librat vërtetë të mirë, jo gjithmonë e kanë suksesin e përnjëershëm. Dante, Servantes, Kafka, Prust, Jojs, Rimbaud, Verlen, Migjeni, etj, etj. Shembujt janë pa fund. Suksesi i vërtetë i një libri të mirë vjen me kalimin e viteve, pesëvjeçareve, dekadave. Librat e mirë kanë nevojë përfaktorin kohë, gjithashtu edhe për një kritikë profesioniste.



nale. Ndaj, shpesh, suksesi komercial i menjëershëm i një libri, shitja e tij e përnjëershëm shumëguhëshe, determinon po lumburinë e krijuesit, por nuk determinon faktin nëse ai roman, ai libër pra, është vërtetë një vlerë universale, e cila do t'i rezistojë me doemos kohës. Deri edhe shumë nobelistë që mbushën dheun me bujë, koha i ka hedhur tej në koshin e pamëshirshëm të harresës letrare. "Gjithçka të keqe mund të bëjë koha", shprehet Kadare. "Por, ajo nuk harron kurrë një gjë: T'i japi atë që meritojnë, vlerave të vërteta letrare".

Ejca, integrimi i ngadaltë i librave të mirë në pëlhurën e shoqërisë, është edhe mallkimi më i madh i librave të mirë, në të gjallë të shkrimtarit. Këtë shkrimtarë e ndjen, e vuan në vëtrinë e tij, nuk e shprehet. "Ah sikur ta shijoja edhe unë sado pak dertin tim, lodhjen tim!" Apo: Është ligj i natyrës, nëse njeriu lodhet për diçka me vite, me dhjetëvjeçarë, ai më në fund do t'i vjelë frutin djersës së vet! Me shkrimin nuk është gjithmonë e mundshme. Letërsia ka dy lloj pagesash. Ose të menjëershëm, me një sukses të vrullshëm si komercial, si në formë fame; ose të ngadaltë, por të përjetshëm. Sa shekuj ka Homeri? Po Eskili? Po Dante? Po Servantesi? Po Shekspiri? Po Kafka? Pak nga këta zotërinj, në të gjallë, shijuan fladin fuqipotë të lavdisë letrare. Askush nuk ua rrahu shpatullat ndoshta me sinqueritet duke i thënë: Bravo, je i madh. Thënë e cila më duket aq absurde dhe idiote në vërvete. Heshtja plot respekt është më e bukur. Shkrimtar, ashtu siç e vuan dhe siç nuk e shpreh faktin që aq e aq shumë energji ka konsumuar, aq e aq shumë u ka lodhur, u ka shqetësuar me hamendësimë, përkime, dyshime, pagjumësi, silitje mendore. Aq dha aq shumë kohë ka humbur (fituar në të vërtetë), për të shkruar një libër, - 3000 orë ndoshta -, sa veç ai e din se ç'hoqi. Dhe ja tani. Produkti i shpikur nga mendja, produkti i përfunduar, jo vetëm që nuk arrin të pëllë të mira materiale, veç në disa raste të rralla; por ai do të bëjë krejt të kundërtën. Ka nevojë që ti të nxjerrësh nga xhepi, të investosh për kriesën tênde. Absurde. "Ma chi me lo fa fare!", thonë italjanët. Shkrimtarit i vjen t'i flakëri fletët e bardha të dorëshkrimit nga dritarja (tani s'ka as fletë më, gjithçka virtuale) le të hapen në erë faqet e shkruara, le t'i lagë shiu, le t'i marrë era, le t'i shkelë makinë e huaj. Nuk prodhojnë asnjë kacidhe. Vlen mundimi titanik? Po? Jo? Por, shkrimtarit vazhdon të shkruajë. Ai ka besim te shkrimi. I ka dhënë besën muzës, po ashtu edhe muza i ka dhënë besën atij. Janë lidhur pazgjidhshmërisht, fatalisht me

njëri tjetrin, si vëllezërit siamezë. Akti i shkrimit është një nevojë fare e brendshme, është një ekzigjencë shumë e thellë e njeriut. Ka mallkim më të madh se ky? Të rralla kanë qenë rastet kur shkrimtarët e mirë, librat e mirë, kanë korur një sukses të menjëershëm, të bujshëm, planetar dhe e kanë merituar vërtetë famën. Suksesi vjen me kalimin e kohës, me konsolidimin e veprës letrare. Është pra libri, i ngjashëm me një investim energjje me afat të gjatë, ndoshta 50 vjeçar apo shkullorë. Një investim për njeriun.

Ndaj ata, lexuesit e kujdeshëm, të rafinuar, të ditur, nuk e hedhin kurrë tej një libër me vlera të vërteta. Ata e ndjejnë atë në lëkurë, kur libri i komunikon diçka të thellë. Ata fillojnë dhe e dashurojnë atë në heshtje, pak nga pak, me porcioane të rezervuara. I kthehen, sepse e ndjejnë që aty ka diçka të vërtetë. Ka jetë. Ka lëng, esencë jete. Ata e përcjellin atë libër nga një lexues te tjetri. Nga një shok te tjetri. Flasin për të në kafene, në darkat me miqtë dhe ja, libri, pak nga pak merr gjithnjë edhe më shumë vlerë. Kjo është e famshëm, passaparola. Libri, ose shkrimi, për shkrimtarin, shpesh është vërtetë si një mallkim i bukur, sublim. Aq shumë energji, pra. Aq shumë forcë, vullnet, këmbëngulje, disiplinë, lodhje, sa nevojitet për të shkruar një libër dhe ja fundi i ngjarjes. Ky mund pa fund, zor se kthet kollaj mbrapshët në formë kënaqështë materiale dhe shpirtëre.

Po deri diku, me kalimin e viteve, një farë kënaqësie shpirtëre kthet mbrapshët drejt krijuesit të tij. Sidomos kur shkrimtar, i paepur, i pathyeshëm, ngul këmbë, nuk e braktis idealin, çështjen, dashnoren e tij abstrakte. Lexuesi, pak nga pak fillon dhe ta çmojë mundin dhe dertin tênd. Takimet mbi librin janë gjithmonë të bukura dhe të vëçanta. Ndonjëherë arrin edhe ndonjë çmim letrar, po nuk që i trukuar, dhe ndoshta, me kalimin e dhjetëvjeçarëve, arrin edhe ndonjë kacidhe leku, apo duartrokite kritikësh me prestigj. Por, me gjithë mundin e tyre titanik, falas, pa shpërbirim, shkrimtarët vazhdojnë të shkruajnë. Sa shumë paskan për të thënë? Por, qenkan më keq se një det i trazuar me fjalë! Qenkan një lumë i rrëmbyer bjeshkësh! Sa shumë paskan akumuluar mor të uruarit? Qenkan si ujëvarë kilometrike! Slik t'ia kishin myllur gojën për shekuj me radhë? Por, ja që edhe shkrimtarët i nevojiten një kombi. Ato janë ndërgjegjja e tij, janë aparati hulumtues, analizues i një kombi. Ata janë pika më e lartë dhe sublime e ndërgjegjes së një kombi. Shpesh ata janë pararojë në identitetin e një populli.

Gëzimi më i madh, lumburia më e madhe estetike e njeriut, besoj se është

lumburia krijuese. Aty në magjen e tij, në oficinën e tij, në karpenterinë e tij sekrete, aty ku nga asgjëja, mbahuhet historia, aty qëndron edhe lumburia më e thellë krijuese. Nuk ka, besoj, kënaqësi më të madhe, se sa krijimi dhe sidomos sesa leximi. Borges shprehet se ajo që e bënte më të lumbur nuk ishte shkrimi, por leximi; kur akumulonte në memorie, shijonte botët e të tjerëve, duke i lexuar me èndje, pak nga pak, dho aktiviteti i tij krijues. Shkrimtar, pra, lodhet veç për të kënaqur estetikisht të tjerët. Ai është një Krisht, i cili sakrifikohet për t'i mbushur të tjerët me shpirtin e tij. Një Krisht i kryqëzuar tek arti i tij, plot gjak, plagë dhe djersë, i cili punon, siç e thashë krejt falas. Është një shenjt, i cili nuk paguhet nga askush, megjithatë ai vazhdon ta bëjë misionin e tij gratis. Të japë copa mundi, lodhje pa fund për art magjie, siç shprehej Lasgushi. Pse? Pse e bën? Ndoshëta ndihet i pa-zë, i lënë mënjanë? I harruar?! Ndoshëta ndjen frustracionin e inferiorit? Apo ndoshëta ndjen atë nevojën e brendshme që të ballafaqohet, të krasohet, ta masë shpirtin e tij me atë të të tjerëve? Pse e bën? Apo ndoshëta sepse duke ndarë shqetësimë e tij me shqetësimet e së njëjtës specie njerëzore, ai konfirmon po atë që edhe të tjerët ndjejnë, vuajnë, shqetësohen, apo ngazëllohen, njëlljo si ai. Pra, edhe të tjerët, gjejnë tek ai, të njëjtat brenga, mungesa, ankthe, tundime, zjarre sekrete plot afsh të pamundur. Ky shkëmbim emocionesh, kjo ndarje emocionesh të përbashkët, kjo marrëdhënie shpirtrash është në vetë ADN-në njerëzore. Njeriu ka nevojë për konferma, për ndodh, përngjarje, si dhe për zbavitje letrare. Kjo nevojë ka lindur bashkë me njeriun. Oq kur rapsodët e lashtë grekë dhe ballkanas shpërndanin këngën nëpër festa dhe nëpër sheshe qytetesh prej mermeri. Më vonë në doli shkrimi, libri, dhe tanj jemi tek epoka digitale. Ndërron mjekit, forma materiale e komunikimit, por ekzigjencia e brendshme për të treguar, ajo nuk do të shteret kurrë tek njeriu. Akti i të lexuarit, është edhe ushqimi shpirtëror më fisnik që njeriu bën. Ky ushtrim intelektual, jo vetëm e mban atë të gjallë, por e bën erpor, e ngre atë, e lartëson nga masa dhe e shndërron në simbol. Intelektuali është analizuesi dhe konfirmuesi i së Vërtetës. "Po nuk e thamë ne të vërtetën!", i rrëfen Rimbaud Verlenit, "Kush do ta thotë vallë atë?" Shkrimtar, njeriu i kulturës, kthet këtë referimi për të analizuar fenomenet, dukturitë e reja të jetës. Njeriu nuk ka nevoje veç për ushqim, komoditet, apo të kënaqë dëshirat e tij shtazarë dhe instiktive. Ai ka nevojë në radhë të parë për ushqim shpirtëror. Dhe një nga format më sublimë të përhithjes së këtij ushqimi shpirtëror, është akti i leximit. Duke qenë njeriu e vetmja genie me arsyë, atëherë truri i tij, vetylë shndërrohet në një laborator akumulues, hulumtues, arsyetues, analizues, deri sa ta vjelë esencën e mesazheve të shkrimtarëve të tjerë. Klasikët. Dija, kultura, akumulimi i njohurive, është një nga gjestet më sublimë, magjepsë që njeriu ka në dispozicion. Arsyetimi është akti më i adhurueshëm i njeriut. Përmes librit, ai jo vetëm nxë dhe mëson, por ai edhe zhvillon, përpunon, zgjidh, hulumton, përmes arsyetimit edhe problematikave të jetës. Të reflektohet thellë mbi jetën është një privilegi i madh. Ajo është edhe lumburia më e thellë e një shkrimtar. Ai kthet këtë filozof të jetës. Lumburia krijuese e tij, edhe pse e mallkuar, është një lumburi e plotë. Një nga kënaqësitë më të thella të cilat mbushin shpirtin e krijuesit në art. Si në pikture, si në këngë, si në muzikë, po ashtu edhe në artet e tjera krijuese, por sidomos në shkrim.

STRATEGJIA E DISKRIMINIMIT KULTUROR

Diskriminimet kulturore në mënyrë kaq klasike si te ne mund të hasen vetëm në politikat e egra nacionaliste e raciste. Kjo politikë në ditët e sotme botën e civilizuar do ta tmerronte deri në palcë. Atëherë, pse nuk ka dhe nuk shprehet asnjë shqetësim për këtë diskriminim kulturor antishqiptar nga vëzhgues e diplomatë perëndimorë që veprojnë te ne, sidomos nga ata faktorë që janë mburojë dhe përkrahës të denjë të diversitetit kulturor



Nga Avni HALIMI

Në Komisionin parlamentar për kulturë, më vitin 2010, shpesh u loz loja e njëjtë politike "me një të rame dy të vrante"! Së fundmi, shumica etnike parlamentare maqedonase përfitoi pikë politike te ndërkombeartët ndërsa sërisht e provokoi nervozizmin te shqiptarët duke ua nxjerrë në shesh mosnjohuritë mbi mënyrën e zhvillimit dhe avancimit të jetës kulturore në vend. Komisioni në fjalë, veç të tjerash miratoi dhë shënimin e disa përvjetorëve me rëndësi historike e kulturore për shqiptarët e vendit. Jo po na u deshtën nëntë manifestime të tilla, jo po mjaftojnë vetëm pesë, jo po u shpreh diskriminimi kulturor kundër shqiptarëve, jo po partia shqiptare në pushtet paskësh arritur që me këto pesë shënimë na ndërrojë karakterin e shtetit të Maqedonisë prej shtetit monokulturor në atë shumëkulturor!

Këto batuta edhe një herë dëshmuar përdiletantizmin kulturor të deputetëve shqiptarë! Disa ditë më vonë, do të pasojnë titujt e shkrimeve si dhe deklaratat e deputetëve shqiptarë në Parlament se, Ministria e Kulturës nuk i përfill vendimet e Parlamentit për sa i përket shënimit të përvjetorëve historike e kulturore shqiptare. Nëse nuk përkrahen edhe kësaj radhe këto vendime të Parlamentit të Maqedonisë atëherë ashiqare paskemi të bëjmë me diskriminimin kulturor që po e ushtrua kjo Ministri kundër shqiptarëve të Maqedonisë! Po a do të bie poshtë ky konstatim i pamohueshem nëse financohen këta pesë përvjetorë? Mjerim e turp!

Parlamenti nuk është oj

Deputetet shqiptarë assesi të kuptojnë se kjo me këto shënimë përvjetorësh është vetëm një bllof i ulët dhe asgjë tjetër! Sepse, Parlamenti nuk është organizatë joqeveritare që merret me të tilla aktivitete, sepse Parlamenti nuk aplikon dhe nuk konkurrion në asnjë sektor të Ministrisë së Kulturës, sepse Parlamenti çdo vit një muaj më parë miraton buxhetin vjetor të Qeverisë, rrjedhi-

misht edhe atë të Ministrisë së Kulturës buxhet ky që hartohej në bazë të projekteve, programeve të subjekteve të ndryshme por edhe në bazë të prioriteteve nationale të kësaj Ministrie, sepse Parlamenti miraton Ligjin për shpenzim të buxhetit dhe, tek pas një muajve, si rëndomë, debaton për shënimë historike e për aktivitete nationale kulturore. Deputetët shqiptarë duhet të dijnë se ky Komision parlamentar ka obligim që të përcjellë zbatimin e programit nacional të Ministrisë së Kulturës dhe jo të aplikojë me projekte në këtë Ministri. Përvjetorët shqiptarë asnjëherë nuk konsiderohen si aktivitete që përfshihen në strategjinë për kulturë nationale, ndaj dhe qeveria nuk reagon me buxhet shështë për aktivitete të tilla "të paparashikueshme". Kurse Ministria e Kulturës vazhdimisht përgjigjet se "askush nuk mund t'i imponojë aktivitetë e projekte për të cilat paraprakisht nuk janë ndarë buxhet nga ana e komisioneve që me muaj punojnë për programin nacional të Ministrisë". Deputetët shqiptarë duhet t'i japid fund lojës e cila nga deputetët maqedonas shfrytëzohet sa për t'i dëshmuar aftësitë e tyre manipulative.

"Pjetër Bogdani" (nën këtë emër ishte ngritur iniciativa për themelimin e Institucionit për trashëgimi kulturore dhe shpirtorë të shqiptarëve - Shkup) është Institucioni më i thirrur për të vlerësuar se cilët përvjetorë do të mund të shënohen, se cilat aktivitete nationale do të mund të organizoheshin në sferën e kulturës. Natyrisht, edhe asocacionet e ndryshme kulturore, ansamblet edhe shoqatat historike, edhe fakultetet, edhe universitetet, edhe komuna dhe katundet, të gjithë mund të organizojnë përvjetorë përkatës, aktivitete kulturore, promovime e tubime shkencore, madje pa marrë leje dhe pa pritur miratime as nga Parlamenti dhe as nga asnjë institucion tjetër shtetëror. Ndërsa financimi i tyre sigurohet ose me donacione, ose me sponsorime, ose nga buxheti shtetëror. Por, për të përfituar nga ky buxhet paraprakisht duhet të aplikohet dhe të konkurrohet në konkursin për programin nacional, në rastin

konkret, të Ministrisë së Kulturës. Kurse për t'i shtyrë ato projekte përpëra këtu duhet të këmbëngulin anëtarët shqiptarë nëpër komisionet e Ministrisë së Kulturës.

Programi nacional për kulturë pa kulturë shqiptare

Moskalimi i projekteve shqiptare, apo kalimi i tyre në numër minimum gjithsesi që është një diskriminimi kulturor ndaj shqiptarëve, i cili po ushtrohet në mënyrë permanente dhe përpërt ortodokse! Pa dyshim që diskriminimet kulturore në mënyrë kaq klasike si te ne mund të hasen vetëm në politika të egra nacionaliste e raciste. Kjo politikë në ditët e sotme botën e civilizuar do ta tmerronte deri në palcë, atëherë, pse nuk ka dhe nuk shprehet asnjë shqetësim për këtë diskriminim nga vëzhgues e diplomatë perëndimorë që veprojnë te ne, sidomos nga ata faktorë që janë mburojë dhe përkrahës të denjë të diversitetit kulturor! Nuk ka shqetësimi nga "faktorët monitorues" sepse nuk ka ankesa seriozë nga "shqiptarët" në pushtetin aktual, të cilët, gjithnjë e më shumë po mburen se ia kanë dalë që Maqedoninë e Veriut ta shndërrojnë në shtet multietnik e multikultural! Shoqatat dhe individët e ndryshëm shqiptarë vazhdimisht ankohen dhe reagonjë për moskalim të projekteve "kombëtare"! Eliminimi i diskriminimit kulturore ndaj një etnie duhet të jetë brengë dhe punë e subjektit politik që participon në pushtet dhe jo e një shtëpie botuese apo i një asocacioni minor e entuziast. Diskriminimi kulturor duhet të parandalohet që në strategjitet politike që fshihen nëpër programet nationale!

Ministresha për kultura, Elizabeta Kançevska Milevska, me t'u emëruar në këtë post lëshoi një letër qarkore deri te të gjithë institucionet kulturore të vendit që janë shfrytëzues të buxhetit shtetëror, prej të cilëve kërkoi që sa më parë të përgjigjen me shkrim për prioritetet kulturore në periudhën e ardhshme katërvjeçare 2011-2015. Nëse një i huaj e lexon me kujdes program nacional për kulturë do të mrekullohet nga gatishmëria e kësaj Ministrie për të investu-

ar në avancimin dhe në ruajtjen e diversitetit kulturor në vend. Në atë program ka plotë teori, plot përkushtime përmbrojtjen dhe avancimin e vlerave kulturore të bashkësive të tjera etnike! Në botën e civilizuar ministritë përkatëse përkujdesen përinstitucionet nacionale, ndërsa asociacionet kulturore dhe organizatat joftimprurëse përkujdesen që të sigurojnë sa më shumë donacione dhe përkrahje për projektet kulturore!

Aktualisht, në Maqedoni funksionojnë rreth 120 institucione kulturore shfrytëzues të buxhetit! Prej tyre nja 5 a 6 janë që menaxhohen nga drejtori shqiptarë. Është shumë e arsyetueshme që këta drejtori të shtrojnë më shumë prioritetet dhe të kërkojnë më shumë përuavancuar vlerat kulturore të shqiptarëve të këtushëm. Por, që në start do të cungohen e masakrohen ato prioritetet shqiptare. Ky program nacional me këta prioritetet kulturore pastaj shtrihet në kuadrin e planit pesëvjeçar që paraqitet si strategji nationale qeverisë së vendit. Edhe nga kjo strategji faktorët ndërkombëtarë mbësin gojëhapur! Aty do të hasen plotë teori për angazhimin e qeverisë përvancim dhe përkrahje të çdo kultura në çdo cep të vendit, përuajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, përkujdesje të veçantë për artistë e kulturologë të vendit, përuajtjen me xhelozit të vlerave të mirëfillta kulturore...

Në të mirë të kësaj propagande antishqiptare do të janë edhe prononcimet e politikanëve tanë të papërgjegjshëm që për t'i ruajtur përfitimet nga të qenët në pushtet do të deklarojnë se, situata e përgjithshme e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut është shumë e mirë ndaj të gjithë duhet të angazhohemi në zgjidhjen e konteksteve ndërkombëtare të shtetit për euro-integrimet që e presin!

"Mirëkuptimet" e kulturës maqedonase

Këta politikanë dhe subjektet e tyre partake, duke qenë të kënaqur me financimin e dy-tre librave, me financimin e dy-tre shfaqjeve teatrale, me financimin e dy-tre koncerteve amatore, nuk çanë kokë për atë se çka po i ndodhë Institutit për Trashëgimini Kulturore të Shqiptarëve të Maqedonisë, si u dëbua nga selia e vet, në Kurshumlihan, fare nuk u skuqëri nga prezantimi promovues i dhjetëra asocacioneve kulturore maqedonase, i artistëve maqedonas, nga mbajtja e qindra ditëve kulturore ekskluzivsh maqedonase nëpër botë që u organizuan përgjatë viteve 2010-2011!

A e kuptuan ndonjëherë politikanët shqiptarë se si u plotësua Pyetësori për implementimin e Konventës së UNESCO-s e vitit 2005! Në asnjë raport, në asnjë pyetësor, në asnjë program e strategji të pushtetit maqedonas nuk flitet për kulturën shqiptare në këtë hapësirë. Gjithandje prezantohet, propagandohet dhe nënvinohet se këtu frymon vetëm kultura maqedonase e cila ka "mirëkuptim" përpërlitjet e kulturave të bashkësive të tjera etnike marginale!

Kur të kihen parasysh të gjitha këto fakte - kush mund të jetë ai sagllam njeri që mund të vlerësojë se, mosshënim i një date të rëndësishme shqiptare nuk duhet të na zgjidhur çështjen e flamurit, pastaj të emrit, pastaj të konteksteve kulturo-historike me bullgarët etj. "Shqiptarët" e Parlamentit të Maqedonisë prioritet kishin këta probleme, ndërsa maqedonasit e Gruëvskit e të Zajevit kishin për prioritet ngulfatjen e çdo kultura tjetër në të mirë të kulturës së tyre që do t'u zgjidhë çështjen e shtetit komb!

Interview me Sibel Halimin, poete dhe sociologe

POEZIA, MANIFEST ESTETIK QË NDËRGJEGJËSON NJERIUN

Poezia e mirë përmban ADN e autorit/autores, dramën dhe dilemat e tij/saj, përmes të cilave ai/ajo vendos dialog me epokat para dhe pas, kulturat dhe botëkuptimet tjera.



Interviewer: Zyrafete SHALA

Sibel Halimi është poete dhe sociologe. Deri më tanë ka botuar katër vepra me poesi: "Kopshti i mëkateve", "Qenia nuk banon këtu", "Me ekzistu është vetë kuptimi", "Zoti më dashuron mua" si dhe përbledhjen eseistike "Shoqëri në alarm". Aktualisht ajo është duke doktoruar me temën "Trupi si konstrukt shoqëror: Drejt sociologjisë së trupit në Kosovë" dhe është ligjëruuese në Universitetin e Prishtinës. Njihet si aktiviste për barazi gjinore dhe të drejtat e grave. Me angazhimin e saj, ka arritur që disa çështje që kanë të bëjnë me gratë, t'i vë në fokus të debatit publik.

HEJZA: Angazhimi juaj jetësor e profesional zhvillohet mes dy fushave të ndryshme, sociologjisë dhe poezisë; në cilën nga këto të dyja mendoni se arrini të kontribuoni më shumë?

S. HALIMI: Sociologja dhe poezia si një simbiozë janë të përbrendësuar në krijimtarinë time. Ndaj, si të tillë ekzistonjë duke qenë të pandara, thuaqse e ndihmojnë njëra - tjetrën për të mbijetuar. Në relacion me sociologjinë, e cila kundron realitetin ashtu siç është, poezia ta jep mundësinë e projektimit të diçkaqe që të bën të ndihesh mirë, njëfarë shtegtimi imagjinar për të dëshirueshmen. Kur shpresa humbet, poezia ta

jep mundësinë e konceptimit të vetes në relacion me të tjerët, ajo është shpëtim.

Trajtimi i fenomeneve sociologjike në shqërinë kosovare, shpesh më ngjason me njëfarë vargëzimi sociologjik. Poëzia, është një lloj zgjatimi, ku fenomenet marrin trajtë artistike, e vargu shndërrohet në revoltë, indinjatë, ndaj si i tillë nuk e përbush veten vetëm në aspektin metrik. Poëzia është shëmbëllim i vvetvetes, katarsis dhe nostalqji për atë që s'ë ke, për atë që e do dhe për atë që mbas mund të mos jetë e arritshme kurrë. Shprehja nëpërmjet vargjeve është ngarendje pas lirisë, ngase aty përplotësohet uni dhe dëshmohet se liria individuale është mbi të gjitha.

HEJZA: A ju kujtohet momenti apo periudha kur për herë të parë e keni ndjerë nevojën për të shprehur ndjenjat përmes poezisë?

S. HALIMI: Kujtoj veten të shqetësuar me ambientin shoqëror që më rrëthonte. Nuk kam mund asnjëherë të qëndroj indifirente karshi tjetrit/tjetrës, nëse do të gjendej në pozita diskriminuese. Prandaj, shkruaja përt qenë zëri i të pathënës dhe kështu ndihesha e çliruar.

HEJZA: E keni ende poezinë tuaj të parë?

S. HALIMI: Poezinë e parë nuk e kam, por para një vitit arsimtari im i letërsisë në sirtarin e tij prej mësimdhënësi e kishte poezinë që e kisha shkruar në klasën e IV, i vetmi kujtim poetik i fëmijërisë sime. Poezia titullohej "Lamtumira e përgjakur".

HEJZA: Edhe pse poëzia i bashkon të gjithë poetët në një komunitet, arsyet e të shkruarit të saj janë të ndryshme për secilin poet. Madje, pikërisht këtu lind edhe relacioni specifik mes poetit dhe poezisë; thënë ndryshe, këtu formësohet mënyra e trajtimit të poezisë nga ana e poetit. Cila është marrëdhënia juaj me poezinë? (Çka është poëzia për ju? Pse shkruani?)

S. HALIMI: Poëzia është thelbësoria e ekzistencës. Vështirë të arrij ta përkufizoj dhe të vë në korniza, madje edhe të personales. Por, nëpërmjet poezisë arrij të ballafaqoj veten me të jashtmen. Shpëtohem nga vetja dhe të tjerët kur shkruaj. Shpeshherë reflektoj se si do të duket jeta ime pa shkrimin, poezinë. Mbështetet kufizuar në fizikën. Me poezinë arrij të arratisem nga definimet, të cilat na mbajnë peng të ngujuar në realitetet e paracaktuara. Ndaj, çlirimini që ma sjell poëzia, frymëzoj e inspiroj lirinë edhe për gratë.

Sigurisht, kur shkruajmë jemi të vëtmuar dhe të shqetësuar jo përveten e të tashmen, sa për të ardhmen e afërt e gjeneratat që vijnë. Natyrisht, letërsia ndër të tjera ka edhe një mision politik. Me politikë nënkuqtoj frymën që tentojmë ta krijojmë. Premisa, nëse mund ta emërojmë kësosoj, e poëzive të mia e ka fokusin te gratë, jetën dhe padrejtësitë që u bënë asaj përgjatë historisë.

Sa herë që mendoj për ta konceptuar gruan, më duket sikur ia bëj të padrejtën e radhës sikurse vetë historia. Të gjitha etapat, duke e përfshirë edhe feminizmin, janë përpjekur përt të definuar atë, ndaj në këtë ngarendje me dashje apo jo, ne kemi vendosur gruan brenda projekteve tonë. Ajo është përtëj konceptimit shoqëror dhe politik. Gruaja dhe liria janë të disiplinuar dhe kontrolluar

duke përcaktuar role dhe përgjegjësi statike, andaj gruan nuk mund ta konceptoj ndryshe, përpos si liria vëtë. Pa mëdyshje, nacionin grua do ta kisha zëvendësuar me liri, ndoshta vetëm në këtë mënyrë do t'i kishim zbutur mëkatet ndaj saj.

HEJZA: Si e shihni rolin tuaj si poete dhe sociologe në shoqërinë moderne? Am mendoni se mund të jeni një zë i rëndësishëm në rritjen e ndërgjegjësimit për çështjet sociale dhe promovimit të ndryshimit në shoqëri?

S. HALIMI: Ndërgjegjësimi nuk lind, por është diçka që zhvillohet dhe rritet përmes edukimit, përvjës dhe reflektimit. Një person me ndërgjegjësim të lartë është i aftë të reflektojë mbi veprimet e tij, të vlerësojë ndikimin e tyre në të tjerët dhe të marrë vendime të përgjegjshme.

Prandaj, në këtë rrugëtim, për të arritur ndryshimin na duhet një angazhim gjithë shoqëror. Rrjedhimisht, qëllimi brenda meje ekziston dhe jeton pamëdyshje. Sigurisht, shkruaj për të bërë ndryshimin, gjithmonë për një shoqëri më të drejtë dhe të barabartë për njerëzit. Ndërsa, sa arrij të ndikoj, besoj që vetë nuk arrij ta konkludoj.

HEJZA: A mendoni se poezia ka kapacitetin për të ndryshuar mendësitet dhe qëndrimet e njerëzve në lidhje me çështjet sociale? Na veçoni ndonjë poezi tuajën?

S. HALIMI: Poëzia është një mjet shumë i fuqishëm për të shprehur emocione, për të eksploruar thellësishët temat e ndryshme dhe për të nxitur reflektimin dhe ndryshimin e mendimit.

Krijon lidhje emocionale midis lexuesit dhe autorit, duke i bërë lexuesit të ndjehen të përfshirë në përvjën dhe perspektivën e tjetrit. Ajo mund të ndezë imagjinatën dhe të hapë mendësinë e lexuesit ndaj një realiteti të ndryshëm, duke shfaqur perspektiva të reja dhe duke shkaktuar reflektim mbi qëndrimet dhe besimet ekzistuese.

Përmes fjalës së saj të fuqishme, mund të përcjellë mesazhe të rëndësishme për të drejtat e njeriut barazinë gjinore, diskriminimin, padrejtësinë sociale, varférinë, luftën, paqen dhe shumë tema të tjera të rëndësishme shoqërore. Ajo mund të krijohet për të shkaktuar emocionet e fortë te lexuesi dhe për të ndërmarrë një thirrje për ndryshim.

HEJZA: Emri dhe angazhimi juaj është i lidhur edhe me lëvizjen feministe, gjegjësisht lëvizjen për të drejtat e grave dhe çlirimin nga kthetrat e patriarkalizmit. Kahas këtij motivi, që zë vend të veçantë në krijuaritë tuaj, cilat motive të tjera nga tema sociale ju interesojnë më shumë dhe pse?

S. HALIMI: Të angazhohesh për të drejtat e grave dhe vajzave është përkushtimi dhe besimi në lirinë, barazinë dhe konceptin e shoqërisë së hapur. Ndaj, motivi për të ndryshuar shoqërinë gjithmonë në të mirë të këtyre të drejtave është angazhimi sublim. Mbështetje, është borxhi ynë ndaj vendit për të orientuar drejt emancipimit e drejt vlerave të përbashkëta evropiane, ku barazia dhe drejtësia

ndaj grupeve të marginalizuara tanimë janë të përbashkëta. Prandaj, nuk kam hezituar asnjëherë të rreshtohem pas këtyre vlerave perëndimore!

HEJZA: A ekziston dallimi në mes grave dhe burrave që bëjnë letërsi, nese konsideroni se ekziston një dallim i tillë?

S. HALIMI: Ndoshta më mirë do të shqyrtoja konceptet ndërmjet "letërsisë femërore" dhe "kritikës feministe". Konceptimi fillostar i letërsisë femërore duket te jetë projeksi patriarkal, përpjekje për të kornizuar letërsinë e grave brenda gjinisë. Derisa e dyta është kritikë, perspektivë feministe mbi traditën letrare, rolet e kufizuar që u atribuoheshin personazheve fiktive të shkrimitarëve si dhe njohjen e shkrimit të grave. Kritika feministe gjatë tri dekadave të fundit na shpie në fokusim dhe tematizimin e nënshtimit letrar të grave, përashtimin e tyre e gjer tek analiza e konstruksionit dhe prezantimit të gjinisë brenda diskurshit letrar.

Andaj, si i tillë, kritika feministe i ndihmoi institucionalizmit dhe legitimimin e feminizmit si vlerë akademike, falë përpjekjes së shumë teoriticeve dhe shkrimitareve feministe, si Mary Wollstonecraft, Madame de Staël, George Eliot, Margaret Fuller, Rebeka West, Virginia Woolf, Simon de Beauvoir e Judith Butler.

Derisa në Kosovë roli i grave në letërsi dhe në art, ende është konceptualizuar në kuadër të paradigmave patriarkale. Vetëm nëse marrim pjesë në grupet letrare, shohim që ekziston një dominim i shkrimitarëve burra, të grumbulluar në grupe të caktuara, të cilët janë në shpërputhje të madhe në mes asaj çfarë shkrujnë dhe çfarë mendojnë e kush janë në të vërtetë. Letërsia duhet të jetë, ndër të tjera, dhe ngacmuese në nervin dhe kallon e shoqërisë patriarkale, duhet të ketë misionin emanicipues, në të kundërtën do t'i përshtatet rahatisë që ua sjell ky sistem. Por, edhe një element i rëndësishëm ka të bëjë me letërsinë e mirëfilltë, e cila duhet të bashkëjetojë me kritikën letrare. Vetëm kësosoj veprat arrijnë të tejkalojnë provincialen dhe të janë e krahasueshme me letërsinë moderne.

HEJZA: Si u lidh poëzia me angazhimin tuaj feminist dhe sa ju ka shërbyer ajo që zëri juaj në mbrojtje të të drejtave të grave të dégjohet më shumë? A mendoni se poëzia ka aftësinë të ndikojë në ndërgjegjësimin shoqëror për çështjet e femrave?

S. HALIMI: Zëri poetik është Zëri i gruas në liri dhe për lirinë, të vetes dhe tjetri/tjetrës. Poëzia e vërtetë është edhe manifest estetik që ndërgjegjëson njeriun se në këtë botë nuk është vetëm. Që i flet njerëzimit me zërin më sublim dhe më të butë për tjetrin/tjetrën brenda nesh!

HEJZA: Cilat janë sfidat kryesore me të cilat një poete feministe përballet në botën e poezisë?

S. HALIMI: Sfidat e poeteve feministe në botën e letrave janë tronditja dhe çarja që shkaktojnë në botën e kontrollit të burrave dhe së dyti,





gratë që i përkasin shoqërive (shteteve) të vogla dhe shkruajnë në gjuhët e vogla, natyrish se mund të mos dëgjohen përtëj stereotipeve për ato shoqëri, kultura dhe gjuhë.

HEJZA: Si e vlerësoni pranimin dhe perceptimin e poezië sociale nga publiku? A mendoni se ka më shumë ndërgjegjësim dhe interesim për këtë lloj pozie sot në krahësim me të kaluarën?

S. HALIMI: Poezia sociale ka ndjekës në çdo epokë, por ajo i nënshtronhet rrezikut që të tjetërsohet në programe ideologjike. Sot, poezia sociale nuk flet më për skamje, por për vetmi dhe humbje në fshatin global dhe teknologjinë e lartë.

HEJZA: Ku e gjeni ju inspirimin tuaj në çështje sociale, apo personale? A keni fazë kur edhe blokohe ni, nuk mund të shkruani?

S. HALIMI: Vështirë të bëhet një dallim i prerë në mes personales dhe sociales në të shkruar. Përditshmëria sociale është pjesë e pandashme dhe jo vetëm. Rrugëtimi i njeriut në ngjarjet politike dhe shoqërore janë inspirimi im. Prandaj, nëpërmjet poeziës përpinqem të çlirorj njeriun nga dogmat e ndryshme që ia zënë frymën atij, e në këtë synim e çlirorj edhe veten. Por, nuk e di nëse e kisha emëruar "moment bllokim", ndoshta do të ishte më mirë ta quanim "moment reflektimi", por nëse për ju është bllokim, në rregull jemi, nuk ka asgjë të keqe as nga formulim i juaj!

HEJZA: Cili është projekti ose angazhimi më i rëndësishëm me të cilin po merreni në këtë kohë?

S. HALIMI: Ka dy dekada që vazhdimit jam munduar të shtyj përparrë kauzat të cilat mendoj se janë tejet të rëndësishme për zhvillimin e vendit, përmes pozitive të ndryshme, kryesisht studimeve, letërsisë dhe angazhimit publik. Ndërsa tash jam angazhuar politikisht në mënyrë aktive në Lidhjen Demokratike të Kosovës.

Besoj fuqishëm që vlerat për emancipimin dhe të drejtat e njeriut të cilat synoj t'i promovojo me poezinë dhe sociologjinë, ta prekin ndryshimin nëpërmjet politikës. Po ashtu kam filluar një cikël të bashkëbisedimit në Kosovë dhe jo vetëm për të iniciuar debat lidhur me disa tema kruçiale të zhvillimit të shoqërisë së sone.

Jashtëzakonisht e lumtur që njerëzit tanë shprehin interesimin për ta marrë timonin e ndryshimit me synim shoqëritë e emancipuara, por fatkeqësish vendi ynë është ngulfatur nga temat të cilat nuk po ndikojnë në ndryshimin e përditshmërisë së tyre. Ndaj, duke qenë sociologe nuk mund të rrija pasive duke soditur gjendjen që e kemi në kontekstin e të drejtave të njeriut dhe grave, ndaj kam marrë iniciativën e këtij dialogu social.

HEJZA: Çfarë në të vërtetë nënkopon emërtimi i librit tuaj me poezi "Me ekzistu është vetë kuptimi"?

S. HALIMI: Njeriu kosovar është i instrumentalizuar nga politika, religjioni dhe konsumérizmi dhe si rezultat ne e kemi humbur atë si një mendje kritike. Ne, thjesht sot e takojmë njeriun që i përket grupeve të ndryshme, kolektives, kokë ulur, e në një ambiguitet të thellë. Prandaj, mesazhi i titullit ka të bëjë me zhveshjen e njeriut nga kuptimet që e emërojnë identitetin personal, çlirim e tij nga kuptimet që i japin vlerë e si rrjedhojë duke mos qenë vetja, njeriu është i humbur.

Ndonëse, rruga për të vetja është e gjatë, prandaj si fillim thjesht duhet t'i gjëzohemi ekzistencës, pavarësisht pasigurisë e konfuzionit që mund të shkaktohet nga fakti që nuk i takojmë askujt. Por, po bëhemë të vetëdijshëm për veten, ne e kemi bërë hapin e parë drejt vetëdijes mbi jetën tonë e shoqërores, vetëm kësisoj mund ta shpëtojmë lirinë.

HEJZA: Gratë dhe dhuna ndaj tyre, si mund ta konceptoni?

S. HALIMI: Për t'i ndryshuar paradigmat shoqërore shtypëse ndaj grave është i domosdoshëm një projekt shumëdimensional i fuqizimit të vajzave dhe grave. Por, më e rëndësishmjë është ndërgjegjësimi gjinor e rritja e vetëdijes lidhur me rëndësinë e barazisë gjinore në vend. Ne duhet të përqendrohemë në identifikimin e shkakut të pabarazisë, nëpërmjet luftimit të stereotipeve e ndarjes tradicionale të roleve gjinore prej edukimit të hershëm.

Trajtimi i gruas si viktimi i ka-

ndihmuar shoqërisë për të unifor muar atë në një të vetme, sepse duke i parë të tilla, kultura patriarchale i ka më të qarta dhe më të definuara pozitat karshi disiplinimit, kontrollit e pushtetit.

Dhuna ndaj gruas asnjëherë nuk duhet trajtuar dhe identifikuar vetëm me termet të cilat e përforcojnë pozitën e të qenët viktimi. Çdo përpjekje për të lokalizuar gruan në viktimë përgjatë trajtimit të dhunës ndaj saj, krijon një normë të re kulturore që përmes gjuhës e shndërron viktiminë dhe dhunën në 'normalitet'. Andaj, kur flitet për dhunën ndaj gruas, në prapaskenë domosdoshmërisht do të përfshihen nacionet si fuqizim e emancipim.

HEJZA: Sa mund të njihet autorinë poezi e tij? Sa shprehet personiliteti juaj në vargjet tuaja?

S. HALIMI: Poezia e mirë përbën ADN e autorit/autores, dramën dhe dilemat e tij/saj, përmes të cilave ai/ajo vendos dialog me epokat para dëpas, kulturat dhe botëkuptimet tjera.

HEJZA: Poezitë në të shumtën e rasteve shprehin preokupime mjaf personale, për shembull dashurinë, frikën dhe vetminë. Poetët shpesh i mbajnë këto poezi për vete pasi janë shumë zbuluese. Keni ndonjë poezi që preferoni ta mbani për vete dhe nëse po, për çfarë bëjnë fjalë?

S. HALIMI: Robert Frost shkruan se 'të jesh poet është një gjendje...' atëherë nëse ne fshehim dhe e mbajmë të ndryshur këtë gjendje, ne e mbajmë të myllur të vërtetë përi njeriun.

Prandaj, vështirë të flasim për këtë dimension, meqë konsideroj që poëtet nuk do të duhet të kishin dilema të tilla. Poezia mban ekzistencën e vet nëpërmjet dashurisë, dhembjes, frikës e vërmisë, nëse poetët fshehin njerëzoren, i shërbijnë vlerave dominuese të një shoqërie. Prandaj, shkruajmë, për ndjenjën e njeriut, përtia lehtësuar atij që nuk është vetëm.

HEJZA: Si e shihni poezinë shqipe sot?

S. HALIMI: Poezia shqipe sot i përshtatet konditave të reja sociale, e larmishme në subjekt, por edhe në rritje të numrit të poeteve. Mbase, zhvillimi i teknologjisë e ka mundësuar shpërfaqjen e poetëve të rinj. Por, megjithatë kritika letrare është e mangët përballë vërvshimit të poetëve, ndaj si e tillë vështirë të bëhet diferençimi i poetëve të mirë. Duhet t'ia lëmë kohës, mbase mund të jetë vlerësuesja kryesore.

HEJZA: Cili është mesazhi kryesor që dëshironi të shprehnë nëpërmjet poeziave tuaja në lidhje me rolin e grave në shoqëri?

S. HALIMI: Mesazhi thelbësor i poeziës është dialogu ndërmjet botëve, përmes trukut ose lojës gjuhësore dhe magjisë që gruan e vë në qendër të qeniesimit njerëzor, as nën as mbi dhe as manash. Ajo duke shkruar krijon një rend të vlerave një hierarki ku më së larti qëndron liria.

Gruaja duhet të jetë sinonim i lirisë! Mbase duke e menduar kështu, mund të çliron edhe burrat nga barra e patriarchut.

PLATFORMA FILOZOFIKE E POEZISË DHE MUZIKËS

Kur bëhet fjalë për artet në traditën islame, pa marrë parasysh se për cilin art bëhet fjalë, arti me të cilin merret artisti nuk është profesioni i vetëm i tij. Çdo person që ka lindur në shoqëritë e ndikuara dhe udhëhequra nga kultura islame këtë atmosferë e merr që nga fëmijëria. Situata është e tillë edhe në artin e muzikës

Nga Metin IZETI

Edhe pse është diskutuar me shekuj se është e lejuar ose e ndaluar, në asnjë mënyrë nuk mund të mohohet vendi i madh që ka zënë muzika në shoqërinë islame. Teksti i Kur'anit nuk flet në mënyrë direktë përmasën juridike fetare të muzikës, ndërsa në shumë vende me miradhi flitet përmarrësia filozofike të artit dhe artbërjes. Qëndrimi i Pejgamberit ndaj gjithçka që është e bukur dhe e dobishme, si dhe ndaj muzikës, jep një shembull konkrèt për qëndrimin pozitiv të Pejgamberit ndaj muzikës. Përkundër gjithë kësaj, disa teologë që mendojnë pak në mënyrë më të ashpër, janë përpjekur të vërtetojnë se muzika ishte e ndaluar duke interpretuar me forcë disa ajete, por, krasas kësaj, ky art vazhdoi zhvillimin e tij të natyrshëm në qytetërimin islam.

Muzika si art dionizian

Sufijtë kanë argumentuar edhe me pikëpamje të tjera se muzika nuk është e ndaluar. Një nga këto pikëpamje më të rëndësishme ka të bëjë me Xhenetin, ilustrime të të cilat shfaqen në ajetet dhe porositë pejgamberike. Në këto përshkrime theksohen se në Xhenet do të luhet muzikë dhe me të do të argëtohen banorët e Xhenevit. Në fakt, sufijtë i quan pikëpamjet e tyre edhe më tej dhe deklaruan se kuvendet e sema'së (oratoriut mistikë) janë pasqyrimi i kuvendet të sema'së në xhenet. Sipas tyre, "kuvendi qellor në xhenet është shembulli (prototipi) më i lartë i kuvendeve të tyre. Muzika në xhenet u konceptua si e përbërë nga tingujt e lëvizjes së gjethave të pemëve dhe këngët e kënduara nga banorët e xhenetit. Asambleja në qellor, e cila është shembulli i sipërm i kuvendeve qelllore, konsiderohet si asambleja në të cilën pejgamberi Davudi a.s. do të lexojë nga Zebulli (Psalmet) me zérin e tij të burkur.

Muzika zë një vend të rëndësishëm jo vetëm në fenë islame, por edhe në pothuajse të gjitha doktrinat mistike. Në veçantë, muzika, e cila u mundëson mistikëve të kalonjë në ekstazë, kërkonte respektimin e një karakteri austistik në ndërtimin e objekteve të kultit. Muzika që gjithmonë në një lidhje me jetën fetare. Është Tesavvufi që brenda fushës së kulturës dhe qytetërimit islam i dha vlerën e vërtetë muzikës, e cila gjithashtu ka një pozitë të rëndësishme edhe në kulturën dhe traditën e përgjithshme islame.

Edhe pse ka një vend të pazëvendësueshëm në të gjitha doktrinat mistike, ky dimension mistik i muzikës është më shumë i pranishëm në lindje sesa në perëndim. Në këtë aspekt, muzika lindore ndryshon nga muzika perëndimore dhe kjo cilësi mistike, e cila e mban pikturën e saj të lirë nga ankthi i perspektivës dhe historinë e saj nga karakteri dramatik, ndoshta e ka detryuar muzikën lindore të jetë monofonike. Kjo domosdoshmëri është një tjetër tregues i pamundësisë së artistit për të thyer modelet e traditës kur bëhet fjalë për artet orientale. Duke bërë një vlerësim mbi artet islame në përgjithësi, lirisht mund të thuhet se format, ngjyrat dhe mënyrat që janë përsëritur me shekuj dhe janë riprodhuar me besnikëri të devotshme në shkrim, muzikë, miniaturë, qilima dhe arkitekturë janë mahnitëse. Vetë artistët i janë bashkangjitur vargut të artit dhe janë shëmangur në vënien e një vule individuale mbi veprën.

Muzika klasike zë një vend shumë të rëndësishëm në artet islame, herë si qëllim



estetik e herë si mjet i rëndësishëm që i shërben qëllimit final, afersisë me Krijuesin. Duke marrë parasysh debatet përmë muzikën në botën islame në kuadrin e dilemës ligji fetar-urdhri mistik, mistikët mbajtën qëndrim në favor të muzikës, dhe kështu muzika u zhvillua veçanërisht në qarqet sufiste, pasi lehtësoi kalimin e sufistëve në gjendje të ekstazës dhe përfjetimin e adhurimit. Muzika e çon sufiani në sferën hyjnore, duke i prishur lidhjet me botën e dukshme. Muzika nuk është art apollonian (si artet pamore që tjerëqin shqipat, si piktuра dhe skulptura), por është dioniziane (abstrakte). Nuk e lidh dégjuesin me mendime konkrete, por e çon në imaginatë abstrakte. Në muzikë, ndjenjat e dégjuesit janë në ballë dhe jo në shqipat e tij. Muzika nuk i kufizon njërit në ndonjë kontekst konkret, qoftë vizualisht apo dégjueshëm. Për këtë arsy, ajo prek njërit më shumë se artet e tjera. "Ky efekt i muzikës i atribuohet faktit se meloditë janë marrë nga rrötullimi i qiejve". Sipas legjendës, Pitagora shpiku muzikën bazuar në tingujt e lëvizjes së sferave.

Tingulli i parë i muzikës hyjnore

Në rastet kur tema për të cilën flitet është dashuria sufike, mënyra më e shkurtër dhe më efektive për ta shprehur është poeziq dëgjuesit muzikë, edhe në poezi ritmi ka një rëndësi të madhe. Poeti kërkon ritmin në bazë të ekzistencës, harmoninë e pandryshueshmë pas gjërvave që ndryshojnë, duke e pasqyruar këtë në strukturën e vargut. Muzika në traditën islame ka marrë forcë me përvojën sufive. Mevlivanet, të cilat u themeluan pas Mevlâni Xhelaluddin Rumiut, i cili edhe veta luante me instrument dhe i kushtonte rëndësi të veçantë "nejit", kanë shërbyer si konservator dhe muzika klasike ka mbijetuar me shekuj, veçanërisht me përpjekjet e kompozitorëve dhe muzikantëve mevlevitë. Gjithashtu, diskutimet e zjarra që ai pati me teologët për temën e muzikës zbulojnë vendin e artit në jetën e tij. Përveç kësaj, bie në sy intensiteti i termave muzikorë në simbolet që ai shprehet në veprat tij. Fjala "nej" në vargun e parë të Mesnevi'së të tij, në të cilin ai shkroi vetë tetëmbëdhjetë dyvargëshet e para, nuk është vetëm një tregues i një instrumenti të caktuar, por njëkohësisht është edhe një koncept filozofik i njeriut të përkryer dhe të plotë. Referencat e tij përfshijnë qenien e përsosur njerëzore, penën, besimtarin, Pejgamberin.

Neji, i cili respektohet në traditën mevlevite dhe quhet "nej-i sherif", më tepër evokon "insan-i kamil'in (njeriu e plotë)" të tesavvufit islam. Duke kujtuar besëlidhjen parazënafillore me Zotin dhe fjalimin e Zotit drejtuar shpirtrave, sufiu "kthehet në atë përmasë në harmoni me ritmin e muzikës dhe duke u kthyer, ai shpëton nga forca têrheqëse e gravitetit, domethënë nga tona. Tani më ai është shkëputur plotësisht nga format dhe ka filluar të shijojë sërisht kënaqësinë e të qenit një me të Dashurin e tij. Në këtë kuptim sera (oratori i mistik) është një nga simbolet e ribashkimit me origjinën. "Për Mevlânën, ngjari u krijimi është tingulli i parë i muzikës hyjnore; për kriesat e mëvonshme, të ringjallura nga zëri hyjnор, që kapen për njëra-tjetërën për të marrë pjesë në vallëzimin e mbretërisë hyjnore.

Formimi i kësaj traditë muzikore në botën islame është padyshim rezultat i një procesi të gjatë. Poeti që dëshiron të jetë original dhe krijues duhet ta njohë gjithë këtë proces, pra të jetë i pajisur me njohuritë paraprake. Edukimi i dhënë në medrese e solli edhe poetin klasik të divanit në një pozitë më të favorshme se poeti popullor. Prandaj, poetët e divanit, të cilët përgjithësisht morën arsim të rregullt në medrese, e morën në konsideratë këtë proces në poezi të tyre, ndonëse têrthorazi, si kërkessë e traditës islame.

Poeti që e gjen veten në këtë traditë, nuk e mohon traditën, por ai do të jetë ndryshe nga të mëparshmit dhe do të jetë një poet në vete sipas këtij ndryshimi dhe suksesi. Me fjalë të tjera, poeti do të synojë të thotë më mirë atë që është thënë dhe do të përdorë disa instrumente (mjete) duke e bërë këtë. Një nga këto mjete është muzika. Duke pasur parasysh se struktura muzikore është synimi jo vetëm i poetëve të Divanit, por edhe i të gjithë poetëve në të gjitha letërsitë botërore, në përputhje me urtësinë Zeburit (Psalmi) "Nuk ka fjalë të pathëna nën qill", poeti do të përpinqet të kapë "të bukurin". Poeti në vend që të kërkojë fjalë të pathëna, tanë është i dhënë pas muzikalitetit. Sepse është një zë i bukur në këtë kupolë që ka mbetur...

Çdo fjalë përvëç vlerës plastike ka një vlerë melodike

Poeti do të krijojë një thurje të tillë mes fjalëve në poezinë e tij dhe do t'i bëjë përshtypje lexuesit me këtë strukturë muzikore. Prandaj, poeziq e tij do të gjejë respekt në

masën e suksesit të tij. Me fjalë të tjera, poeti do të krijojë një strukturë arkitekturore në një farë mënyre. Ajo që do të bëjë ndikimin kryesor të lexuesi është rendi që poeti do të japo me fjalët, me harmoninë e brendshme të fjalëve dhe me ndihmën e elementeve të Jashtëm si metri dhe rima. Struktura muzikore është shumë e rëndësishme në këtë aspekt dhe është thelbësore për ekzistencën e poetit: "Poetët e divanit përrëdhënie bashkëtingëllore zanore, përsëritje në nivele të ndryshme, elemente ritmike si rima dhe metri, si dhe vlerat vokale të formuara në gjuhën në rregullimet e tyre zanore. Falë kësaj muzike që krijoj, poeti do ta çojë lexuesin në botën realiste të poezi së së divanit, e cila i ngjan miniaturave dhe mohon iluzionet dhe do ta bëjë të jetojë "momentin". "Ritmi, në një farë mënyre, na mundëson të kuptojmë dhe të përqendrohem në të qenit si një krijim i vetëm dëhe një 'moment solid'. Rrotullimi i Mevlânës në pazarin e argjendarisë, i kapur në ritmin e goditjes me çekan, është një ngjarje tipike që tregon cilësinë dhe funksionin e ritmit. Njeriu, i cili ka arritur harmoninë kozmike, është i lirë nga të gjitha kontradiktat dhe çlirohet nga ndjenja "qesharake" e krijuar nga bota e paraqitjes". Përsëri, "poezia është një têrësi shprehjesh e ndërtuar mbi ritëm, një rend foljor. Në fakt, ritmi përbën bazën dhe thelbin e të gjitha arteve të bukurë. Sepse aty ku nuk ka ritëm, mungon uniteti dhe mbretëron rrëgullimi dhe pasiviteti. "Gjërat që një poet duhet të ketë më shumë për të krijuar muzikë në poezi është të kuptuarit e tij për ritmin dhe fuqia për të shkrirë këtë strukturë ritmike me poezi... Një poezi osse një pjesë e një poezie zë vend fillimi i shpëtimit si strukturë ritmike, atëherë kjo strukturë ritmike gjë shprehje me fjalë e ide dhe lind imazhe".

Shkrimtarët lindorë, e vëzhgojnë artin si nga pikëpamja psikologjike dhe fetare ashtu edhe nga pikëpamja estetike, me gjithëse ata njohin përvojën estetike të shkaktuar nga adhurimi dhe përfjetimi mistik. Për ta, hapësirat dhe objektet e artit të shenjtë kanë një tjetër vlerë të shtuar, shumë më domethënëse se përvuja estetike. Ajo vlerë është në ndikimin që këto veprat kanë në moralin dhe natyrën shpirtërore të atyre që sodisin/i përfjetojnë ato veprat.

Në letërsinë europiane nis udhëtimi i parë si sfidë për t'u përballur me të bukurën. Fiset helene të bashkuar nisen drejt Trojës. Për shkak të erës së kundërt u fljuja Ifigjenia, vajza e Klitemnestrës dhe Agamemnonit. Pas fljimirit era fryu drejt Trojës dhe anijet u nisën. Fataliteti në rrugën drejt së bukures nis që në zanafillë. Duhej paguar çmimi i lartë si sfidë për të takuar të bukurën, si sfidë për t'u përballur me të. E bukura do të shoqëronte dhunën, trimërinë, pushtetin, famën edhe gjatë përplasjes midis trojanëve dhe akeveje. Brenda një lufte të madhe për të bukurën midis trojanëve dhe akeveje, kishte edhe beteja të vogla për të. Akil hyjni largohet nga luftha për shkak se Agamemnon kreshtniku i mori forcërisht të bukurën, Brisidë faqetrenë filen: /"Shkoni në çadër te Akil Pelidit,/ m'sillni për dore Brisidë faqe bukurën."

Mërinë e Akilit mundi ta shuanë



Vetëm Athina sykaltra: "Prej qiellit zbrita të zbut mërinë tënde..." Për hir të bukurisë së rrëmbyer me forcën e pushtetit nga Agamemnoni, u sakrifikuani turma të tëra akejsh të vrarë nga Hektor zemërtimi. Epi "Iliada" gjatë tetëmbëdhjetë këngëve flet për mërinë e Akilit ndaj Agamemnonit për shkak të Brisidës së bukur. Vetëm gjashtë janë këngët e tjera të poemës, që nuk flasin për këtë çështje. Në botën e vogël të asaj kohe u shfaq një vektor force ende i panjohur mirë, ende i paperceptuar në të gjitha përmisasat, forca e dashurisë. Njerëzimi tanë do të kishte në duart e tij një armë të paparë, e cila do të ndërtonte botën, do ta bënte atë më të bukur, dashurinë.

Orvatja e parë drejt së bukures së "grabit" ishte tejet e dhunshme nga akejëtë dhe po aq e dhunshme dhe dëshpëruese mbrojtja e saj nga trojanët. Nëse do të njihej mirë dhe do të vlerësohej ajo ndjenjë e madhe me të cilën do të ngjizej e njyjetohej bota më pas, konflikti midis akeveje dhe trojanëve do të zgjidhej në çast: Priami dhe Agamemnoni do të vendosnin përballë njeri-tjetrit Menelaun dhe Paridin. Pastaj do të thërrisnin Helenën dhe do ta pyesnin: Do udhëtosh për në Spartë apo do qëndrosh në Trojë? Vetëm një lëvizje koke në një drejtim do të fashiste luftën dhe do të kursente jetët njerëzore, do të kursente edhe një qytet-

ërim nga groposja. Natyrisht, kjo nuk mund të ndodhë sepse jemi në mug të njerëzimit kur ende gruaja dhe për rrjedhojë edhe bukuria e saj, shihej thjesht si pronë e burrit.

Udhëtimi i dytë në letërsinë europiane nuk është më pak epik se i pari. Nëse tek i pari shhtysa që bukuria, tanë krahë saj, kemi edhe një arsyë tjetër sipërane, dashurinë. Uliksi (Odiseu) niset drejt Penelopës së bukur, pjekur e tharë nga malli. Pengesat, tundimet, mundimet, të panjohurat rreziqet dhe të papriturat e udhëtimit të gjatë nuk e lodhën sepse kishte si yll polar Penelopën e bukur, atje në Itakën e shenjtëruar, në Jonin blu. Krejt ndryshe nga udhëtimi i parë, udhëtimi i dytë është plot aventura dhe rebyse, që nuk do të zgjidhen me forcën e muskujve, por me forcën e mendjes.

Nga mugu i njerëzimit i përcillet qytetërimi një mesazh domethënës nga Homeri: ka një forcë më efikase se forca e muskujve për të ndryshuar botën, është forca e mendjes. Udhëtimi zgjati plot dhjetë vjet, po aq sa edhe lufta, por nuk e zbehu, nuk e theu dëshirën e Uliksit për të shkuar drejt Penelopës. Shumëkush

lart indiferent, ndërsa Atena syqillorja i lutej: "...Po mua më ther zemra sa më s'bëhet/ për të shkretin Uliks, t'urtë, po fatzi, që ka sa kohë, i ndarë nga miqtë, vuan / në një ishull që n'çdo anë e rrahin dallgët/ në mes të oqeanit pa kufi./

Pasi u end detrave dhe ishujve, pasi kaloi sprova të rezikshme e të mundimshme, Uliksi arriti dhe u shfaq i denjë para Penelopës, që ndriste nga bukuria dhe virtuty: /"Kështu veç Penelopa u përmallua/ sa njohu burrin; s'ish prandaj e zonja / nga përqafimi i ëmbël të shkëputej.../

Uliksi udhëtoi, sikurse shumë udhëtarë të sotëm, për t'u larguar nga vetja, ose për të zbuluar, gjetur a formuar një identitet tjetër pas atij rrënimit që la pas, rrënim që e polli mendja e tij. Në fakt, ai vazhdon të udhëtojë ende. Tek çdo udhëtar i sotëm gjendet nga pak Uliksi.

Udhëtimi i tretë në letërsinë europiane vjen në veprën e një autori të shquar, siç është poeti i antikitetit romak Virgilji, i cili në ndryshim nga Homeri, nuk e këndoi, por e shkroi veprën e tij, falë epokës në të cilën jetoi. Edhe tek poema e njohur Virgiljii udhëtimi nis nga lindja dhe vijon drejt perëndimit: /"Unë armët po këndoj dhe atë burrin, i cili mu prej viseve të Trojës /mori arratinë, se ashtu, pra, deshi fati.../

Nëse Uliksi udhëton drejt Penelopës, zemrës së Atdheut të tij, Itakës, fitimtar, Enea ka humbur gjithçka. La pas Trojën e rrënuar dhe u nis për udhë me imazhin e saj të shenjtë. Mbi shpinë ka "at(dheun)", (babanë e tij plak) dhe për dore mban birin e tij. Te "buka" e gatuar me mjeshtëri nga Virgilji, ndihet aroma e miellit homér, sidomos në gjysmën e parë të veprës. Enea është në kërkim të së bukures që e ka në mendjen e tij dhe në genin e tij. Ai është djali i hyjneshës Afërditë. Edhe ai është në kërkim të një atdheu tjetër po aq të bukur sa Troja. Nëse gjatë udhëtimit nuk do ta ndeshë një Trojë tjetër, lipse ta krijojë atë. Enea arrin në Epir dhe ndalet në qytetin e Butrintit ku takon Andromakën, gruan e Hektorit: /...kalojnë në fund brigjeve të Epirit/dhe hyjmë pastaj në portin e Kaonisë/dhe jemi pranë qytetit të lartë Butrint.

Më tej, në udhëtimin e tij, magjepset nga një grua e bukur sikurse ishte Didona e Kartagjenës. I goditur nga bukuria dhe për rrjedhojë edhe nga dashuria për gruan e bukur, Enea zgjedh për atdhe pikërisht Didonën dhe një shpellë si strehë. Me ç'duket që në zanafillë e bukura është atdheu i preferuar të gjithëve. Fatin e tij e ndërron, sikurse edhe në epet homér, një hyjneshë, e éma e tij Afërdita, e cila e dyturon të niset sérish në udhëtim, duke i kujtuar se nuk është ky fati i tij. E gjen fatin e tij te Lavinja e bukur, vajza e mbretit Latin. Edhe Enea përballet me një sakrificë të madhe. Për ta merituar bukurinë ka para sfidën e ndeshjes me Turnin, mbretin e rutulëve, i cili dëshiron të njëjtën bukuroshe. Beteja, siç dihet, përfundon në dyelin midis Eneas dhe Turnit, i cili mposhtet nga trimi trojan. Enea e pranon sfidën për t'u përballur me të bukurën dhe e fiton atë. Trashëgimia e tij, sikurse origjina e tij, do të jetë një nga bukuritë e ardhshme të botës, Roma.

Ati i njerëzimit, Kronidi e ndiqte nga

(Përfundon në numrin vijues)

ÇLIRIMI I ENGJELLIT

Angelus Novus, është një përbledhje poetike, e cila përvèç se mban vulën artistike të autorit, po ashtu na mahnit me bukurinë e vargut, mjeshterinë e fjalës

XHEVDET BAJRAJ

ANGELUS NOVUS

PÖZI



Arsim HAMITI

Natyrisht, duke qenë se ky libër na vjen tash kur autori nuk është fizikisht me ne, dhe poezitë janë të shkruara pak para se ai të ikte nga kjo botë, domosdø se secilit lexues ia krijon idenë se brenda vargjeve duhet të ketë diçka të veçantë që nuk shihet në lexim të parë. Mbështetjet e parandjenët të autorit, një fjalë të fundit të tij, apo ndoshta një kod sekret që vetëm ai do të dinte ta fshihe ashtu qetë- qetë mes vargjeve të bukurë e të cilëra të tij. Por, a nuk kishte

gjithmonë poezia e Bajrajt këtë mision që lexuesin ta befasonte, o me një varg predikues, o me figura të përbysura që natyrshëm krijojnë mesazhe plot fuqë brenda vargjeve të tij. Natyrisht se po, të gjitha përbledhjet poetike të Bajrajt, gjithmonë kanë pasur dhe kanë atë misionin fisnik që lexuesin ta bëjnë që të mahnit me kuptimet e reja që marrin nga jetët dhe gjérat në jetën tonë dhe ta shoh botën plot me ngjyra të reja. Njëkohësisht ta tronditë atë me idetë artistike që shndërrohen në mesazhe kuptimplota, ushqejnë shpirtin tonë dhe na bëjnë herë pas here të ndjehemi të sigurt se është dikush që na e transmeton atë dimensionin e pashpjegueshëm të botës.

Por çfarë ka të veçantë në të vërtetë në përbledhjen e fundit të poetit tonë të madh Xhevdet Bajraj. A gjinden têrë ato elementet e njohura nga poezia e tij e mëhershme, apo ka edhe diçka më shumë. Në të vërtetë, në një vështrim të thuktë, ne në këtë përbledhje, sikur ta parandiente të ardhmen e tij, Xhevdet Bajraj na sjell më të plotë se asnjë herë tjetër botën e tij poetike që përbëhet nga ide, motive e tema të ndryshme nga jeta, jo vetëm e tija por e një jetë të përbashkët të gjithë neve që jetojmë në këtë kohë. Dhe në të vërtetë si asnjëherë më parë, ne kuptojmë se universi i tij artistik përbëhet nga disa koncepte filozofike të cilat shpërfaqen fuqishëm me anë të tri krye temave që enden lirshëm pothuajse në çdo poezi të tij. Dhe këto tri krye temave poezi tonë të mirënjohur janë, atdheu, lufta dhe jeta, të cilave autori si figura të përbysura ia kundërvë tri të tjera, mërgimin, lirinë dhe vdekjen, për të na sjellë artin e tij poetik, jo vetëm të

veçantë por edhe të jashtëzakonshëm. Vështirë të ketë një poezi të kësaj përbledhje që në mënyrë të ndryshme nuk trajton këto koncepte që herë na dalin si ide, e herë si motive që zhvillohen në tema qendrore poetike për të na dhënë mesazhin e plotë vetëm pasi përbledhja të lexohet dhe të analizohet në plotin.

Atdheu, pra thamë se është jo vetëm krye tema e parë por edhe brengë e parë e poetit. Ai e ka atdheun si një thembër të Akilit që vret sa herë që nga atdheu vijnë lajme jo të mira, sa herë që e sheh se atdheu nuk është ashtu siç do të donte të ishte, apo sa herë që atij i mungon të gjenit në atdhe. Ai në një poezi të tij thotë se i ka mbetur një këmbë në atdhe e një tjetër në Meksikën e largët ku ai jeton. Ai ndjen si i takon dy vendeve të largëta që qëndrojnë si kundërpeshës mes vete dhe në mes të tyre ka një oqean të madh të mbushur plot me mall dhe kujtime që e kanë kapluar plotësisht. Lufta e fundit në Kosovë, apo krye tema e dytë është përndryshe brengë e dytë e poetit. Përballë luftës qëndron liria si kundërpeshës e saj. Por çfarë të thotë shpirti i poetit kur lufta ka përfunduar, e liria keqpërdoret e keqkuptohet çdo ditë. Dhe poeti vëren se vuajtja dhe dhembja si dy elementet që prodhohen dhe njëkohësisht natyrshëm qëndrojnë mes këtyre dy figurave qendrore, nuk ikin lehtë nga ky vendi ynë. Ato vazhdojnë të janë të pranishme fuqishëm edhe më shumë se dy dekada më pas, sepse lufta ka lënë gjurmët e sajë të fuqishme mbi ne e liria nuk ka ardhur e plotë. Mbështetjet e parandjenët e tij, mërgimin, lirinë dhe vdekjen, për të na sjellë artin e tij poetik, jo vetëm të

kemi vdekur në atë pranverë të luftës", pra nga lufta asnjëri nga ne nuk kemi shpëtuar vërtetë të gjallë.

Krye tema e tretë e poetit në këtë përbledhje thamë se ishte jeta. Jeta në të vërtetë është krye tema që veçon poezitë e këtij cikli, le ta quajmë të poezive të Xhevdet Bajrajt. Këtu ai është shumë më filozofik dhe më i thellë në ide dhe më i pasur në figurin artistike. Përballë jetës ai e vendos vdekjen si kundërpeshës e fuqishme të saj. Ai thotë se "si mund ta quaj të bukur këtë botë në të cilën gjëja më e natyrshme është vdekja", pra ai as që pranon ta quajtë natyrshme një jetë që sjell në masë të madhe vetëm dhembje e trishtim, dy elemente të cilat fuqizohen figurativisht dhe konceptualistët mes këtyre dy figurave kyçë. Këto tri tema pra, atdheu, lufta dhe jeta, të cilat autori ia kundërvë tri të kundërtat e tyre, në të vërtetë përbëjnë atë trekëndëshin artistiko-filozofik të poezisë së Bajrajt, që në vete përbën plot ide, motive e tema tjera. Ai kujdeset që gjithë afinitetin e tij krijues dhe mjeshterinë e fjalës t'ia nënshtrojë këtij trekëndëshin që ka kapluar qenien e tij poetike dhe artistike, duke krijuar në të vërtetë një univers të tij original prej nga buron poezia e tije bukur. Dhe më e bukurë është që brenda këtij trekëndëshi të poezisë së tij shpërthen fuqishëm dashuria, e cila është elementi që përshkruan pothuajse çdo poezi të tij. Është dashuria për gruan, familjen, të afërmit, miqtë, popullin dhe mbarë botën që përvèçë shpërfaqet si një koncept universal dhe hyjnor, ngjyros me nuancat më të bukurë vargjet e poezive të kësaj përbledhje.

Roman

NË SHTRATIN E RIGJALLNIMIT

Kliton NESTURI


Duam apo nuk duam, ta pranojmë me plot gojë apo nën zë, Petrit Palushi është një nga individualitetet më të spikatura të letërsisë shqiptare të këtij çerek shekulli. I dëshmuar si i tillë, qysh në romanin e tij të pare "Prroi i Andriës", ai ka sjellë gjithnjë risi dhe befasi në të gjitha veprat që ka shkruar më pas, duke na sjellë një frymëmarrje të spikatur. Temat e tij kanë qenë të përzgjedhura me kujdes dhe krejt origjinalë, e po kështu stili mbi të cilin ato janë shkruar ka qenë gjithnjë i freskët dhe befasues. Krijimtaria e tij ka ardhur gjithnjë në rritje, çka na ka bërë që ta mirëpresim atë gjithnjë me kureshtje.

Ndryshe nga mjafit autorë të tjerë, të cilët në krijimtarinë e tyre hera-herës humbasin edhe në vorbullën e zhgënjimit, Petrit Palushi ka mundur të qëndrojë solid në artin e tij, gjithnjë në perfekcion. Kjo vihet re edhe në veprën e tij më të re romanin "Shtrati 13". Në pamje të parë, një temë e zakonshme spitali, vendosur në pavilonin e reanimacionit të një spitali të vogël, një njeri që ndodhet i shtrirë mes jetës dhe vdekjes, e që në

fund nuk e di se si do të lëvizë prej andej. Por merita e autorit është se ai del tej së zakonshmes, duke thyer koncepte njerëzore dhe skema letorraine. Ndërtuar me një stil të thjeshtë narrativ ku shpaloset bota e brendshme e rjeriu kur ndodhet në rrëthana të tilla, "Shtrati 13" është një veprë ku dashuria dhe humanizmi, njerëzorja dhe thyerja e tabuve, shpalosen bukur dhe dinjitetshëm. Personazhet që frymojnë brenda një hapësire të vogël, përçojnë një peshë të madhe si bartës të një shoqërie sa moderne aq edhe arkaikë, sa të vogël së Jashtmi, po aq të madhe së brendshmi.

Një ndër pasuritë më të mëdha që na sjell kjo veprë, veç strukturës, stilit dhe befasisë letorraine, Petrit Palushi na shpalos edhe pasurinë gjuhësore. Duke u mbështetur në shprehje frazeologjike dhe fjalë të përdorura kryesisht në veri të Shqipërisë, ai fut në letërsi një armatë leksiku të vyer dhe të domosdoshme si për letërsinë, po aq edhe për lexuesin, duke arritur që ta shkrijë atë në mënyrë të përsosur me gjuhën standarde letorraine. Vet Palushi në këtë rast është një urë lidhëse në këtë bashkëjetesë, duke

arritur të na e sjellë atë bukur dhe në mënyrë organike. Për autorin gjithçka ndodh në një mëdësinë ku krijimtaria e tij jeton. Ai është një shkrimitar modern dhe sjell shembullin më të mirë se si mund të bashkëjetojnë në shqipen letorraine standardë dhe dialekti. Dhe këtë e bën thjeshtë, pa patur nevojë për dekretë konventash apo kongresesh drejtshkrimi. Pasuria e tij gjuhësore është një kontribut i cili mbetet denjësish në letërsinë dhe kulturën shqiptare, duke qëndruar edhe si një model referimi në çdo kohë dhe prej gjithkuqit. Romanii "Shtrati 13", ashtu si e gjithë krijimtaria e Petrit Palushit, është një veprë që meriton vëmendje nga kritika, lexuesit dhe artistët. Ajo flet vazhdimisht, duke na inspiruar drejt më të mirës, jetës, dashurisë dhe të vërtetës.



Në shiritin e kohës

CAMAJ MIDIS LENI RIEFENSTAHL DHE MARLENE DIETRICH

Dashnor KOKONOZI

Herë pas here poetit Martin Camajt i nxjerrin nga sirtaret disa dokumente ku tregohet se ai gjatë arratisë së tij ka pasur një farë kontakti me shërbimin sekret amerikan, Cia. Thuhet edhe se Cia e ka shpërblyer duke i paguar nja dy a tre pulla poste për dërgimin e librave.

Nuk mungon asnjëherë që një gjë e tillë të shoqërohet me komente që synojnë ta cilësojnë sikur ka punuar kundër atdheut të tij, sikur e ka tradhtuar atë, thënë shqip.

Meqë kontakte të tillë kanë ndodhur në Gjermani (më duket) po rrimë po aty për ta parë këtë veprimtarin « kundër atdheut » në një dritë tjetër, me dy artiste mjafë të njohura gjermane me Leni Riefenstahl dhe Marlen Dietrich.

Ndërsa e para punoi me zell dhe jo pa talent për regjin nazist, M. Dietrich që u ndodh në Amerikë kur shpërtheu L2B, jo vetëm që u vu menjëherë të mbledhë fonde për luftën kundër nazizmit, por edhe shoqëroi kudo trupat amerikanë në marshin e

tyre edhe në atdheun e saj, në Gjermani për t'i inkurajuar në luftën e tyre kundër nazizmi. Sot ajo adhurohet për artin dhe integritetin e saj moral.

Për të Gjermania nuk mund të identifikohej me nazizmin, sikundërët Shqipërinë e asaj kohë vetëm ndonjë mendje e trazuar mund ta identifikojë me regjimin komunist që e mbodhi me 27 burgje (nëse nuk gaboj, nga 2 që ishin më parë) dhe me plot 32 kampe internimi, pa llogaritur gropat e përbashkëta që i sherbyen si varreza dhe të vrarët pa gjyq që nuk u gjinden ende eshtërat.

Ka edhe një element që flet shumë. Sikundër propaganda naziste dhe të gjitha tmerret që lidhem me të që sot identifikohen më fort me Leni Riefenstahl, ashtu edhe propaganda e regjimit të shkuar komunist në Shqipëri sot, më shumë se sa me disa emra jerarkësh, identifikohet me ca poetë, vargjet glorifikuuese të të cilëve kujtohen ende, ndërkhohë që fjalimet mediokre të tiranit janë harruar.


Midis alternativës Riefenstahl - Dietrich, Camaj ka bërë zgjidhjen e tij.



Në shiritin e kohës

ALI PODRIMJA NË POEZINË SHQIPE

Krijimtaria e poetit, edhe pse ecën, lëviz, përplaset, krijon emfazat e veta apo qëndresa të ndryshme tranzitive social-emocionale, ka si të përhershme konstanten e dhimbjes për truallin. Dhimbja për vendin mbetet e palëvizshme



Mailindo RAMA

Ali Podrimja, njëri nga poetët shqiptarë më në zë të gjysmës së dytë të shekullit XX dhe fillimit të shekullit XXI, mbetet po ashtu ndër lëvruesit më të mëdhenj të lirikës patriotike përgjatë historisë letrare të pas viteve '50-të në letërsinë shqiptare. Simbolikën poetike e lidhi ngushtë me kombin, me kulturën materiale e shpirtërore të vendit të vet. Fillim e fund, poezia e tij krijoj fytyrën e një korpusi të gjerë me elemente etniciteti, çka do ta bënte atë poetin më emblematik të Kosovës. Vetëdija poetike.

vetëdija kombëtare dhe vetëdija politike krijonin trepolëshin që kapércentë gati çdo skemë standarde a kuptim të vendosur deri në atë kohë nga poetët kombëtarë paraardhës të Podrimes, kryesishët të periudhës së Rilindjes. Qysh në fillimet e veta krijuese, Kosova për poitin parashtronet si një katakombi i ngatërruar thellë tuneleve të shpirtit dhe i bëhet motiv që e udhëheq në çdo kohë. Filozofia e tij krijuese vjen si një asketizëm vetjak, për të hequr dorë nga gjëzimet e tjera të jetës, deri në gjetjen e përsosmërisë së përgjithshme, që në këtë rast ishte Kosova e lirë. Prandaj poeti krijojnë botë gjeopoetike krejt origjinale, të distancuar nga shtrëngimi i kufijve, ose, më saktë, përtrej kufijve shtetërorë, të cilët gati se nuk i përfill fare, në kuptimin e vrapiimit, shtriries dhe krijuimit poetik.

Krijimtaria e poetit, edhe pse ecën, lëviz, përplaset, krijon emfazat e veta apo qëndresa të ndryshme tranzitive social-emocionale, ka si të përhershme konstanten e dhimbjes për truallin. Dhimbja për vendin mbetet e palëvizshme. Ajo bëhet sinteza e gjithë botëkuptimit të poezisë së tij, i qëndron gjithmonë në backstage, si një trigonomë trikohës: fillim, vazhdim dhe mbyllje. Ashtu si krejt sociumi kosovar, që notonte në ujërat e turbullta të viteve '50-të, edhe poeti i ri Ali Podrimja do të vendosej përballë shtigjeve tepër të vështira, por kurrë nuk mundi të kufizohej nëpër uniforma orientuese apo imponuese të kohës. Si me një shpërthim prej shpirtit, ai do t'u drejtohej bindshëm dhe ngulmues gjithë atyre që kacafyteshin me fatet e shqiptarëve, se nuk mund ta falte atë që ishte gjak, mish e shpirt i atij trualli. Shpërtheu kështu një dritë që ziente prej kohësh në zemrat e gjithë bashkëkohësve të tij, por që asnjëherë nuk ish thënë sa duhej dhe si

Ku suvimi dialesbar i bari tä tiros abtigio.

poetit, duke e bërë fatin e poezisë së tij një me fatin e Kosovës së tij, fate që i mbante mbi supe kudo ku shkonte, edhe në gjëzime, edhe në dhënhërimë. Poezia e Ali Podrimes është thelbi i një rebelimi themelues sociale, që luftonte përmes përparimitare. Ky shpirt reaktiv u shfaq me shpërthime, herë eksplikite (të shprehura) dhe herë implicite (të nënkuptuara). Kjo e bëri poetin më të konsoliduar dhe e inkudroi si vulë identitetare të fateve të vendit, duke u veçuar në komunitetin e krejt poetikës albanofolëse të deri asqai kohe.

I udhëhequr e orientuar nga paraardhësi i tij Esad Mekuli, Podrimja do t'i mbante lidhur fort urat poetike me poetët e mëdhenj kombëtarë, që nga Rilindja e më pas, te brezi i viteve '30-'40, duke sjellë veçantinë e zërit të vet, si vazhdim të një tradite të përkorë letrare. E kishte të qartë vijën, udhëri, boshtin, frymën, në të cilën e cte. Por, veç kësaj, Podrimja ka meritë të riveçanta, sepse i dha një orientim të ri poezisë, si në metodat krijuarë, ashtu edhe në rrashin tematik, duke prurë më natyrshmëri forma poetike të panjohurë më herët. U shfaq si një skalitës i vargut, duke e formatuar atë më të prerë e më të rimeprehëtë. Modernizoi elementet antike e tradicionale poetike, duke e nxjerrë në një tjetër hulli, atë të individualitetit të vet absolut. Debutimi i bujshëm i të riut gjakovar do të kthehet në model shkrimor, që nëpër vite do të pasurohej e përsoset më tej, dhe assesi të qëndronte aty ku nisi. Ishte një kohë kur zëri i poetëve dhe shkrimitarëve dëgjohej dhe bëhej pjesë e zhvillimeve të përgjithshme të jetës kulturore e artistike, në vend, duke kapërcyer përtej dhe mbi rolin e tyre.

Sikurse e thamë më lart, fati i shkrimtarit ishte ngsushtësish i lidhur me fatin e vendit, prandaj Podrimja do të kthehej në zë të asaj gjendjeje të rëndë sociale që mbizotëronte

ato vite. Ai u bë fryma dhe fija lidhëse për ta çuar zërin e qëndresës te çdo qytetar i thjeshtë. Mesazhi i tij u bë mision dhe moto që trokitjen e parë e bëri me vargun emblematik: "Kosova është gjaku im që nuk falet"! Ky varg aksiomatik, i prerë, ishte një thirrje për qëndresë, karakteristikë shqiptarësh ndër shekuj (varg i strukturuar mirë me dallgë shpërthyese nga gjaku që vlonte). Kohën e shënoi me konvencë universale, edhe pse shpërtihente me dhimbje Kosove.

Nëse do të rravgonim në tematikën podrimjane, qysh në fillime do të na paraqitej një panoramë e plotë dhe e qartë e botëkuptimit të poetit. Një shpërfaqje që të çon në fryshtëzime të reja. Kështu, do ta niste hapërimin krijues me hijen e tokës për të mbërritur me fuqitë padronike të poezisë. Pëllumbat në shtëpinë pa qetësi poetit i ishin trembur qysh në fëmijëri, ndërsa kapërcyen përtëj dhimbjes në rininë e hershme të tij. Rrëfimi, rënkim, mallkimi - ishin trinia e mbrëmjes, ndezur në çdo ninullë guri. Netët pa gjumë, ankth, qentë që lehnin shushurimave të plepit, varre mbetur pas kokash-tablo poetike thellësisht therëse që mbinin të pakufishme brenda poetit dhe Kosovës. Në thelb të brendësisë Poet - Kosovë shfaqet prologu dhe epilogu, betimi dhe e përbetueshmja, dita e nata dhe maca më e zezë se terri. Në vargje rritet e rritet kali i Trojës, bashkë me dhimbjen dhe ankthin e tmerrit të tradhtisë nga brenda, tradhti që ia kish marrë Kalanë-Kosovë me dhjetëra herë. Ai ishte mes njerëzve, pas shkundullimës, mes dhimbjes së përflakur që shkonte e vinte në kohën e Homerit. Prandaj, përmes zërit - kushtrim, zërit - kërkues, zgjimtar, rritës shkallë - shkallë, ulëritës dhe insistues të çdo kohe, poeti Ali Podrimia, kërkoi revolucionet.

TI QË MË DO, VRITMË I PARI

Ti i shtove ngjyra tokësore
qielilit tim
që atëherë penelatë e pezullt mbeta
as dhé - as re
pupël e nderur në bebe të syve
çastndalur.

Si vallë të jem ajo që s'jam
e të mos jem ajo që jam?

Ti, ti që më do
merre pyjeten e Çehovit dhe si heshtë
ngulma në brinjë:
"Mos vallë po e mashtron lexuesin...?"

Ti, ti që më do
duhet të më vrasësh i pari,
para se të të vras.

NË MUNDSH TË MË KRIJOJE EDHE NJË HERË

I.
Eshtëpërvjedhur,
pëlhurëmishtë,
Sytë- pasqyrë të përtejme
bota të kish,
Gji nazemëndafsh,
gushë cipëfildish,
Flokkë limanprehje
si mes resh të ish.

Këmbësorkadhe pruar
pyjesh të trishtë,
Ku dehet paraja
me alkimi magjish.
Arsye e gjykim,
mprehtësi më dhe,
një zemër të madhe
që dhe botën e nxë

Ndjenja të bardha
lotë, mall, zjarr,
gjuhë magjiplotë
që dhembjen ndal.
vullnet të lirë,
hare e dhunti
brishtësi fizike
forcë e butësi

Engjëll i rrëzuar
në ligësi.

II.
Kur gruan krijoje, o Zot,
ç'mister, ç'mrekulli,
si vallë s'mendove
për një palë sy,
mashkullit t'ia jepje, ...
të më shihte si TY?!

III.
Në mundsh, o Zot, të më krijoje
për së dyti dhe një herë
do mundje vallë të më ribëje
Të bukur, por kaq të mjerë!?

PRITJA

Të kiske sy për të më parë,
nën lëkurën e fildishtë
nuk më rrjedh gjak në damarë,
por një hare e trishtë.

Vdekjet e bukura të çdo çasti
si nëpër gjethet bien në vjeshtë,
përhumbur në pyje krijuar
të pres të vish, si qindra herë!

Marroset vargu nga vetmia,
vallëzim me ujqërit nis e hedh.
me hënën fjalë numërojmë tespia:
-Shko të flesh! -më thotë -Nuk vjen!

Ah! Të kiske sy për t'më parë,
nën lëkurën e pranvertë...
pritjet si gurë palë-palë,
ngrihen rrëth meje kështjellë.

SI BATICË DO VIJ NË BUZË

Detin e lotëve mbledh në një shishe
në të një varkë nis në lundrim
dëgjohen këngët e sirenave
unë jam vela kredhur si floknajë në erë
deti im nuk është i qetë
si poezia
një albatros s'më lë vetëm
për njëfarë kohe
në mëngjes të vdekur e paskam gjetur
në prehrin tim
stuhia nis, dikush pranë vetes më mbledh
në cilin breg do ta gjej të nesërmën
ti lexomë në harta zvogëluar disavargëshe
zhytur në lëngun e shishes sime
si baticë do të vij në buzë
çdo valë e imja, çdo dallgë deti
asosacione të reja do të të sjellë
dhe ti s'do dish puthjen e kujt përpive
varkës, velës, stuhisë a albatrosit të vdekur
nga lkmia jote
një ditë do të zgjohesh me ethe deti në zemrë.

RUHU DJALË NGA VASHAT SY BLU

Ti mahnjitesh
me sytë e mi të qelqtë,
kur një buzëqeshje
retë e trishta krejt i heq.
S'di me çfarë të përngjasin,
ca pak mendueshëm rri
Vallë janë cifla qelli
përhumbur në pluhur gri,
apo yjz të humbur
qiejve, në pafundësi?!

Ti vështromë i pafrymë,
por veten mos e humb krejt,
për gjëra që s'janë tokësore,
nuk ka etiketë.

Sytë - portë e shpirtit janë
që vjen nga të tjera botë.
Në ke frikë të duash
mos trokit kot!

Ruhu djalë, nga vashat syblu!
Ato shohin yjet, jo ty!

BURRAT S'E KËRKOJNË DASHURINË

Burrat s'e kërkojnë dashurinë
ata duan të posedojnë
janë kaq lakmitarë
harxhojnë paranë
por kursejnë zemrën.
Burrat, pasi eksplorojnë,
ngulin shkopat me flamujt vetjakë
dhe deklarojnë "tokë e zënë"
kjo s'i ndal, nëse do mundeshin
çdo natë do ta zinin një tokë të re.
Ata janë fëmijë marrokë të rritur
dhe një grua e bukur është për ta
pasqyra e Narcizit ku shihen
dhe u pëlqen vetja.

Burrat s'e kërkojnë dashurinë
por kur ajo i gjen, vdes burri brenda tyre
dhe lind Njeriu.

UDHËTAR I PASOSUR

Veten braktisur në mëshirë të fatit
mbi varkë oqeanit të pafund,
lopatat në thellësi i kam lëshuar
vala heshturazi më përkund.

Mall i pakuptuar këmishë e trishtë
veshur shpirtit kur mbi sy yjet më flenë,
veç me flokë mbuluar trupin tim të brishtë
ndër zhuritje buzësh etja ngrë folenë.

Hijen time kam mikeshë të paçmuar
sa kam atë hënë e diell ka,
dhe kur netët qiejt i kanë turbulluar
një këngë në zemër vigjelon si flaka.

Shkujdesur me agun zgjohern ndër supe
e lakuriqtë me veten në sinjeritet,
befas kuptoj që unë jam veç varka
ti je udhëtar i pasosur që frysëzimin pret.

GJERBË MALL

Qërmton shi
Mbi floknajë
Mbi ndjesi
Mbi varg

Shqep kujtimet e qepura
visoreve të zemrës

Gjerbon shi
n'atë oazë brenda meje
ku të strehova ty

Gjerbon mall
férkoj dy eshtra prej tij
ndez zjarr me fjalë

Malli im i bardhë, perlë e rrallë
mes dy heshtjeve, ishullohet.

ÇEL-TI-NË

Ja! Atje tej! Kur yjet shuhën
Atje-jam e shoh një çeltin'
Ku hedhin valle shtojzavallet
Shtoi-o-Zot-vallet e shpirtit tim!


Aty, në atë shteg rrëthuar driza,
Në gjuhë, o mik, e kam shtëpinë
Në do të shoh, në do përfare
Më harro! Kalo! Ti ik!...Ti prit!...

Kur zërat shturen me mëngjesin,
kulloshtër e genies ar-t-pikon.
Kullo një vesë-puthje ndër petale,
nga shteg i vetes që më harron!

Ja! Atje tej! Kur ndizen yjet...
Atje-jam e afër të ndiej çeltin!
Ku hedhur lozin shtojzavallet,
përshfaqe o Zë, gjithë bukurinë!

(Nga përbledhja poetike "Nantë herë grue")

BUNKERI NR 7



Shqipona AXHAM

"Sahit, dikur mu në këtë kodrinë sillnim dhentë. Si i pacipë që ishe," tha tjetri me një farë inati të vjetër që iu ngjall papritmas. "Më lije mua të vrapija pas tyre, kur i trempte ndonjë zhapi, a kur ndonjë dhelpër shfaqeji papritmas. Dhe ti as që doja t'ia dije. Kurrë nuk do ta harroj ditën kur më ngordhi Liska, e kafshuar nga gjarprë në buzën e sipërme. Përqargesa duke të thirrur. Dhe ti, fshehur në guvën e errët në të dalë të kodrinës, mashtroje Resmien, kuçkën e lagjes së poshtme që t'ë ta jepet. Ta plasi shpirtin, po as i shko mendja ta bënte me ty. Dhe mirë ta bëri. Tani jepu duarve dhe pastro mut. Ky bunker që ta dish, éshtë i lidhur me një tunel të gjatë deri në të dalë të kodrinës, futet brinjë më brinjë të saj. Kanë dhjerë në të gjithë ushtarët e repartit matanë. He de mos më shih ashtu, i kam parë me sytë e riu. Nuk kishin faj të rrjerët. Dymbëdhjetë orë shërbim dhe halet i kishin larg."

"Pff, këtu nuk rrihet. Për shpirt të asaj nëne, ta di që më varin mu në shesh nuk futem më thellë. Unë të pastroj mut? Kurrr jo."

"Léri fjalët dhe shtërgo bythën. Mos e dhëntë i madhi Zot, që t'ë marrë vesh sekretarja që kemi braktisur punën. Dhe meqë ra fjalë, se mos i thua kujt që përmenda Zotin, i pacipë. Mos harro që unë të shpëtova kur Resmia t'ë la shakull me gur pas qafës, në mes të guvës."

Këto qenë fjalët kërcënuese të Izetit ndaj Sahitit, djalit shtatlartë dhe të bëshëm, që merre flakë menjëherë dhe ishte zënë më gjysmën e fshatit, por që brigadierë, Fatimes që na ishte dhe sekretare Partie, nuk ia bënte fjalët dyshë.

"Nuk futem më thellë për shpirt të nënës dhe pikë", briti me një zë të çmendur kur rrëshqiti mbi një mut, që si duket ushtarët e kishin bërë vetëm disa orë më parë, sepse ende nuk ishte tharë.

"Shshsht Sahit, pash at Zot, mos u nxe. Do t'ë na nxijnë jetën përsëri me fletë rrufe dhe do na dërgojnë që t'ë hapin gropë a kanale. Ti e di se sa e ligë éshtë kudra."

Sahiti e hodhi një vështrim përbuzës shokut të vet, Izetit, dhe doli nëpërmjet korridorit të tunelit duke sharë.

"Ti rri e pastro mut. Edhe sikur t'ë më varin, nuk futem më aty."

Me urdhër t'ë brigadierës, sekretares së Partisë, Fatimes, ata kishin nisur punën që pa gdhirë. Do t'ë pastroni

dymbëdhjetë bunkerët në shpatin e kodrës, që ngjanin me dymbëdhjetë lunga të pashërueshme.

Dy bunkerët afër xhadesë nuk kishin pasur shumë jashtëqitje. Si duket kalimtarët trembeshin se do t'i shihnin e nuk guxonin të futeshin brenda. Edhe bunkerët që ngrihej në fund të xhadesë nuk kishte pasur shumë, veç njoq dhy t'ë tharë. Si duket ndonjë shofer kishte marrë guximin nga zori i ndonjë diarreje. Ama sa më lart t'i ngjiteshe kodrinës, aq më shumë jashtëqitje kishte brenda bunkerëve. Dhe këtë Sahiti nuk mund ta duronte. E kush ai Sahit, që kish dali i pari në garat me kuaj në fshat, që pati mundur dymbëdhjetë t'ë rinjtë e kooperativës së fshatit fqinj, në një ndeshje miqësore dhe që veç këtyre bërmave që kishin marrë fshatrat gjithandje, dashuronte si i marrë më t'ë bukurën në katund, Rahimen. Zyra e sekretares ndodhej në një ndërtësë njëkatështë t'ë gjatë ngjitur me furrën e bukës. Rrotlën drekës ajo freskohej aty me ndonjë bozë dhe në muzg ikte t'ë maste normat, brigadës. Kur pa Sahitin në derë sa një shpat muri, Sekretares iu këndell një dëshirë e papërbajtshme. Por një gjinkallë që i qe ngjitur për një copë herë portretit të shokut Enver e solli në vete, me zukatjen e saj acaruese. U kollit disa herë si për t'ë irregulluar zërin dhe i hodhi ftohtë sytë nga djaloshi. Ishte kërlleshur nga afshi, kur i pati afuar krahët për t'i vënë në qafë dekoratën e ndërkit. Ama e dinte që ai dashuronte si i marrë atë, më t'ë bukurën e kooperativës, Rahimen.

"Shoja Sekretare, pranoj çdo lloj pune. Më dërgo t'ë hap kanal në rrëpirën e malit, tej luginës së Vanave po deshët, veç këtë punë, pastrimin e tunelit dhe bunkerëve nuk e bëj dot. Për shpirt të nënës që nuk e bëj dot. Më kapin t'ë vjellat dhe koka më vjen vërdallë."

Fatimes iu shkërmoiq një hije gëzimi në ftyrë dhe, duke i bërë shenjë që t'ë ulej, tha.

"Qetësoshu dhe merre pak veten, djalosh. Po deshe pi pak nga boza ime," dhe i zgjati gotën e vet t'ë mbushur përgjysmë.

Pas një copë heshtje, kur në zyrën e vaptë ndihej vetëm zukama e gjinkallës, ajo shtoi.

"Éshtë e turpshme që t'ë refuzosh detyrat që t'ë ngarkon Partia. Shoku Enver na ka mësuar që duhet t'i bëjmë ballë çdo sfide dhe duhet t'ë vërmë intersin e përgjithshëm mbi atë personal."

Sahiti që i urrente këto fraza, që nga mbledhjet e rinisë në shkollë t'ë

mesme, kërciste dhëmbët më kokën ulur.

"Nuk éshtë fundi i botës t'ë durosht për pak kohë erën e jashtëqitjes. Pa paramendo sikur t'ë jesh në luftë. Do t'ë duhet edhe t'ë hash edhe t'ë dhjeshët në atë bunker."

Sahiti u zu ngushtë. Duke qenë natyrë që fliste shumë pak, u ngrit vrik dhy bëri t'ë dilte, duke thënë vetëm këto fjalë.

"Mendova që do t'ë më kuptonit shoja Sekretare. Bëhem keq në bunker dhy më zënë t'ë vjellat. Ja kjo éshtë."

Fatimja e vështroi me adhurim nga pas trupin e tij gjithë muskuj dhy u shkri në një kënaqësi të brendshme dhy t'ë pamatë. Sahiti përplasi derën, pa pikën e frikës dhy u nis drejt xhadesë kryesore, për tek kodrina. Do bënte si do bënte dhy do t'i pastronte ata dreq bunkerësh. Kur sosi tek bunkerë i shtatë e gjeti Izetin duke kafshuar thatë një copë buke misri. Kavanozin me dhallë e kishte pirë t'ë gjithin, i shkrumbuar nga vapa.

"Pash atë Zot, si mund t'ë hash në këtë lemeri? Ptu, ptu" i tha Sahiti dhy nxori një thike t'ë vogël, e zuri te gdhendte një shkop. "Le t'ë na heqë ditën e punës, po unë nuk futëm më në këto bunkerë t'ë dhjerë. I kërkova që t'ë shkoja në kanale, por nuk pranoi, kudra!"

Të nesërmën në mbledhjen e brigadës u bë zallamahi dhy potere e madhe. Fatimja kalli vendin duke ulëritur, që Sahit djaloshi dhe Izet dembeli nuk na kishin bërë normën. Gjashtë bunkerët e faqës së majtë t'ë kodrës kishin mbetur pa pastruar. Nëse nuk do mbaronin punë që t'ë nesërmën në t'ë gdhirë, ajo do ta ngrinte si problem në organizatën bazë t'ë Partisë. Lajmi u hap si kolerë dhy i ranë vesh edhe babit t'ë Sahiti, që desh vu kujën. Ai e dinin e fort mire, që po t'ë vinte Fatimja para, t'ë merrte mortja. Por Sahiti e dinte se çfarë ilaçi mund ta shëronte e t'i kthente mendjen Fatimes. Disa herë shqoja Sekretare e kishte kapur duke e vështruar vjedhurazi me një adhurim që t'ë shtinte frikën. Fytura e saj në formë katrore, e zezë dhy sytë e dalë zhyteshin në trupin e Sahitit, duke u përvëluar nga dëshira. Udhë për tek shtëpia e saj ishte një tatëpjetë, në anët e së cilës fshatarët kishin hedhur plehun, që e ruanin për në vjeshtë. Që t'ë ishte e lirë për t'ë organizuar mbledhjet dhy kuvendet me anëtarët e Frontit dhy t'ë Partisë, t'ë shoqin e kishte caktuar roje nate tek stalla e pulave. I shoqi që një humbammeno, çalaman, që ajo e mori për burrë se i pati dalë nami në shtatë katunde për kurvëri, por kjo

përpresa se t'ë bëhej Heroinë e Punës Socialiste, antare Partie dhe brigadiere.

"Do t'ë ruash pulat Xhelal. Ne duhet t'ë japid shembullin t'ë parët që t'ë shkojmë aty ku ka nevojë më së shumti Partia dhe Populli."

Xhelali i qe bindur meit në ftyrë. Ajo kurrë nuk flinte me t'ë. Biles dhy natën e parë t'ë martesës i pati thënë se na kishte dhimbje mesi. Të nesërmën Xhelali kthehej në agim dhy e vetrnjë gjë që e gjëzonte, qenë dy kokrra vezë, që dhy këto i fshihë dhy i ziente vjedhurazi, kur e shoja iktë në punë. Sahiti shtyu me rropamë derikën në gardhini e sekretares dhy u fut pa thirrur në shtëpinë e saj. Dera ishte hapur. Ajo ishte shtrirë sa gjërë-gjatë në një minder me shalët hapur nga vapa. Pa pritur që t'ë thoshtë asnjë fjalë. Sahiti i tha:

"Shoja Sekretare jam këtu që t'ë kërkoi falje për ato që thashë në mbledhje. Më beso se qeshë kallur në kokë nga vapa e ditës dhy nuk dija çfarë t'ë thoja, ndaj nuk bëra autokritikë. Por ja ku jam, do t'ë bëj c'të më thuash ti, por nuk duhet ta bësh me t'ë madhe në organizatën bazë."

Sahiti e dinte fort mirë se kush ishte Sekretarja.

"Hë mirë, shumë mirë, që më në fund je bindur. Por ulu, s'ke pse rri në këmbë. Éshtë këtu minderi. Sa për dritat e fikura, na grinë mushkonjat. Kështu i fik çdo natë.", ia ktheu sekretarja.

Sahiti zuri vend në një kënd t'ë minderit.

Pasi një copë heshtje, ajo shtoi.

"Jemi t'ë rinj, ndonjëherë dhy rrëmbeheri. Ama më beso që do t'ju mbaja në shpinë dymbëdhjetë herë deri në majë t'ë kodrinës, vetëm t'ë mos pastrojale."

Sekretarja qeshi me një qeshje këndellëse dhy provokuese.

"Si, si, do t'ë më mbanit në shpinë? Haaaa."

"Po, pa pikën e lodhjes", - iu përgjigj Sahiti.

Pas disa minutave heshjte, kur një filad i vonë mbërëmjeje zuri t'ë lëvizte perdet, Sekretarja psherëti si e çlodhur.

"O shqyr më në fund pak freskët, u kallëm vase."

Sahiti nuk fliste, por vështronje me vërmendje çdo lëvizje t'ë saj.

Pas një copë herë mes psherëtive dhy fjalive t'ë tillë si: "Nuk bën t'ë refuzosh detyrën. Ti je i ri, duhej t'ë jesh shembull për t'ë gjithë. Partia i do dhy i mbështet njerëzit e fuqishëm si ti, Sekretarja shtriu këmbën e majtë mes shalëve t'ë Sahitit. Sahiti e dinte fort mire, që ajo mezi por rezistonte, por i tha.

"Të lutem shoja Sekretare, më ka dalë nami për rrugaç, por unë ty t'ë respektoj. Unë t'ë kurrë nuk do t'ë bëja keq edhe sikur..."

"Mos më thirr Sekretare pashë këtë hënë t'ë bukur sonte, Sahit! Thirrë Fatime"

"Betohu që nuk po më provokon Fatime. Unë po dridhem nga dëshira, por besomë që kam frikë. E si mund t'ë bëj dashuri unë me një sekretare Partie. Fundja kush jam unë, një copë katundar, që mezi kam mbaruar t'ë mesmen. Po nuk m'u betove që më dëshiron, nuk t'ë besojo".

Ndërkohë që Sahiti fliste dhy përpjekë që t'ë zgjidhte fjalët, që ajo ta besonte se ai po e dëshironte, sekretarja ishte zhveshur ullak para tij. Duke gulçuar iu hodhi si topth i zi sipër, duke ia marrë frymën. Sahiti psherëtintë dhy nxirre klithma, gjoja kënaqësie, por ndjinte neveri dhy për ta nxjerrë inatin me t'ë, e përplaste me sa fuqi kishte pas murit. Ndërsa Sekretarja vlonte

kënaqësie e hipnotizuar, duke i thurur një mori fjalësh epshndjellëse dhe duke dekluaruar që e kishte dëshiruar, që kur e kishte parë për herë të parë hipur mbi kalë, duke tendosur muskujt e kraheve, të nxirë nga dielli. Sahiti nuk i kthente përgjigje vetëm e ngjeshte dhe e ngjeshte pas murit me inat, me gull, gjë të cilin Sekretarja e përkthente në dëshirë dhe papërmbytje. Kur mbaruan punë, qe errur. Duke e kafshuar pa dhimbje në gushë, Sahiti ia kërkoi dhe një herë betimin. Ajo u betua për të dytën herë në kokë të djalit të vetëm, të diagnostikuar talasernik, që e dërgonte herë pas herë larg në Tiranë, tek një kushëritë i largët, derisa t'i ndërronin gjakun. Të nesërmen Sahiti u zgjuad gjithë gjëzim. Sekretarja i kishte premtuar që do t'i caktonte punë nga më të lehtat. Kështu ai do të mbaronte punë më herët dhe do të kishte më shumë kohë që të qëndronte me të bukurën Rahime. Kur iu afroa brigadës, që mblidhej si çdo ditë në ora 8, ku

ndaheshin dhe punët, Sahiti pa e vënë re të tjerët i luajti syrin Sekretares. Ajo u këndell dhe drodhë zërin, duke i dhënë një timbër të hollë. Të tjerët që e vunë re e panë çuditshëm. Ajo ndau për të gjithë punët, por emrin e Sahitit nuk e përmendi fare. Kur të gjithë u shpërndanë, ajo i tha:

"Ti Sahit do të vish me mua!"

"Patjetër shoqja Sekretare. " iu përgjigji i qetë Sahiti, por një brengë e panjohur zuri ta brente përbrenda.

Sekretarja u nis në të dalë të xhadesë kryesore.

"Për ku kështu shoqja Sekretare?", pyeti pas pak Sahiti.

"Ec dhe mos fol asnjë fjalë!", - ia ktheu me një zë të prerë sekretarja.

Pasi kaluan një rrëpirë më dashqe, Sahiti vuri re që i ishin afruar kodrinës.

Kaluan dy bunkerët pranë xhadesë, edhe atë në fund të saj dhe sosen tek bunkerri i shtatë, që kishte

mbetur që dje pa pastruar. Për dreq ai bunker ishte mu bri guvës ku në vegjeli Sahiti pati dashur të kapte me zor, kurvën, Resnien.

"Po më ndëshkon Zoti si duket. Po, po," mërmëriste me vete Sahiti, duke goditur me sa fuqi kishte gurët rrugës.

Guva bri bunkerit lidhej me një përrua të kthjellët, që në vegjeli, por dhe tani që ishin rritur, luheshin, sa herë imbaronin normën para kohe dhe dielli ende nuk kishte perënduar. Një mendje i thoshte ta kapte zvarrë atë dreq Sekretareje dhe ta shtynte në përrua, por përmbytje. Kur sosen në hyrje të bunkerit, Sekretarja u ndal.

"Derdimen, mendove se do të më mundesh. Tani përvishju punës dhe do ta pastrosh, duke të të parë unë, në rregull!"

Sahiti u mpi.

"Po ti më premtovë. U betova dhe në kokë të tét biri."

"U betova, por ja që e theva

betimin. Tani sus dhe fillo punën"

Sahitit, urrejtja e përbindshme për të zuri t'i dilte muskujve, indeve. U tendos në fytyrë, duke shtrembëruar tiparet e bukura dhe sa hap e myll sytë e zhvesh lakuriq, dhe, duke vrapiuar, u fut në përrua. Shkëmbinjtë përreth dhe ujëvara e vogël që krijonte rrjedha e përroit e bënин pamjen të mahnitshme. Ndërsa trupi i tij i gjatë dhe krejt muskuj thyente ylbertë që formoheshin në mpleksjen e ujtit me dritën e diellit. Herë zhytej në gropën e madhe të ujtit që formoheshi në fund të ujëvarës, herë dilte duke ulëritur një si këngë, një si klithmë. Sekretarja kishte mbetur e mpirë, në zallin buzë ujtit, si një arushë e zezë që mezi pret peshkun të të dalë nga uji. Ndërsa Sahiti zhytej, dilte, zhytej dhe dilte prej ujtit, deri sa organi i tij mori formë vertikale në drejtim të vrimës së zezë që shfaqej buzë ujtit midis shalëve të hapura të Fatimes, si një bunker i fëlliçur, që gjithsesi duhej pastruar.

Poezi: Ezra POUND

PORTRAIT D'UNE FEMME

Mendtë tua dhe ti jeni Deti ynë Sargas, Londra u trazua shkaku yt bash këto vite. Dhe anjet shpresëplota ta lanë këtë apo atë si shpagim: Idetë, thashethermet e moçme, cikërrimat e të gjitha gjëra, Zënkat e çuditshme përdiye dhe çmimet e zbehta të mallrave. Mendjendriturit të kanë kërkuar - në mungesë të dikujt tjetër. Ti gjithmonë ke qenë e dyta. Tragjike? Jo. Ti e preferoje këtë si gjë të zakonshme: Një njeri i mëritshëm që të mërit dhe i nënshtuari i gruas, Një mendje mesatare - me nga një mendim më pak, secilin vit. Oh, ti je durimtare, të kam parë se si rrjje Me orë, ku diç ku mundur të ketë fluskuar. Dhe tash ti e paguan sall një. Vërtet, ti paguan për bukur. Ti je person i njëjëre interesë, njeriu vjen te ti Dhe ta merr me vete fitimin e çuditshëm: Trofetë e grumbulluara: dofarë sugjerimesh kureshtare; Fakt që s'të çon askund; një rrëfenjë a dy, Shtatzëne me madërgona, apo me diç tjetër Që mund të dëshmohet si diç e dobishme e megjithatë kurrrë s'dëshmohet, Që kurrrë s'hyn në punë e as që sjell farë dobie, Apo që gjen çastin e vet në shfaqjen e ditëve; Vepër e mrekullueshme e moçme, e njollosur, e pispilosur; Idhujt dhe qelibari e zbulurimet e rralla, Këto janë pasuritë tua, depozita jote e madhe; e megjithatë Për téré këtë thesar deti i gjëra e gjethrënëse, Pyjet e çuditshme përgjysmë të qullura, dhe gjëja më e re shpresëdhënëse: Në rrjedhën e ngadalshme të drithës së ndryshme dhe të thellësisë, Jo! nëtë s'ke gjë! Para së gjithash e tekembramja, Asgjë s'është bash e jotja. Megjithatë kjo je ti.

CANTO XIV

Io venni in luogo d'ogni luce muto; Kundërmimi i thëngjillit të lagur, politikanët dhe n, kyçet i kanë të lidhur për noçka, Qëndrojnë pullak, Në prapanica fytyra të pispilosura, në bythën e lëmuar syri i zgurdulluar, Çufra si mjekër u rri varur, U drejtohen masave përmës birave të bythës, U drejtohen shumicës në baltë, kërmijtë, salamandrat, larvat, Dhe me ta r, shaminë e bukës të pastër si loti, E ka paluar përposh penisit, dhe m Ai që neveritej nga gjuha e folur, Jakat e kollarisura, por të ndyta, të lidhura rrëth këmbëve, Lëkura me qime, plot puçrra përtet cepit të jakës ka dalë, Matrapazët pijnë gjak të émbëlsuar me mut,

E përbas tyre.....f dhe financierët me zinxhirë të çeliktë i fshikullojnë.

Edhe tradhtarët e gjuhësn dhe tarafi i gazetarisë Ata që gjenjyen për para; çorodat, çoroditësit e gjuhës, çorodat, që etjen për para E kanë vënë mbi kënaqësitë epshore; ulërijnë, shtypshkronja si të ishte kotec pulash, rraptim presash, shpërthim i pluhurit të thatë dhe i letrave të shpërndara, erë e keqe dhe djersë, kundërrim portokajsh të kalbur, bajgë, kallumja e mbrane e gjithësisë, mysterium, acid squfuri, shpirtptaktë, têrbohen; hedhin margaritarë në baltë, dhe ulërojnë ngase balta nuk ngjitet për ta; nënët hasetqare shtyjnë çikat e veta në shtretërit e jetosve, dosa që hanë këlyshët e vet, e aty pilakati EIKON ΓΗΣ, atje: NDËRROHET PERSONELI,

shkrihen si dyll i pistë, qirinj të dobësuar, bythë të mefshta, fytyrat të zhytura në tul, E në llumin përfundi tyre, të ndarë, taban në taban, pëllëmbë me pëllëmbë, agjentprovokatorët Vrasësit dhe MacDonaghut, kapiteni H. shef i xhelatëve; Jashtëqitje e ngurtësuar që dikur ishte Verres, sektorë, Calvin dhe Shën Klementi i Aleksandrisë!

bumballat që futen në mut, Dhe i shkallmuar, llumi plot troshka, kontura të humbura, eroziona.

Përbimi qelbje-ferri birë e madhe bythe, që vuan nga majasëlli, stalaktite të varura, i yndyrë si qielli mbi Uestminster, të padukshëm, shumë anglezë, vend jo interesant,

mjeri, rrënim i plotë, luftëtarët e veseve, pordhin nëpër mëndafsh,

përshtësuar me simbole krishterimi,

..... tund në pipin e hamamtë,

Mizat shpërndajnë lajme, harpitë dhiejnë në fluturim,

Batak rrenësash të kulluar,

hale budallallëqesh, budallallëqesh, e budallallëqesh,

Qelb që vlon nga mutsihanet, përplotë parazitë,

skrajat e cohta lindin skraja të gjallë,

pronarë skutash të ndyta,

kamatamarësit që qijnë morra, këlyshë pushteti,

pets-de-loup, rrjinë ulur në stivat e librave të ngurtësuar,

me filologji mijegullojnë tekstet,

që me veten e tyre i fshehin,

ajri pa asnjë kënd qetësie,

luzmë morrash, dalja e dhëmbëve,

dhe mbi të oratorë që ta thijnë karin, gromësirje bythe predikuesish.

Dhe Individia,

mitosje, myk dhe kërpudhë,

shtazë jargavelle, eshtre të shkrirë,

kalbje e ngadalshme, djegje infektuese,

bishta të përtypur cigaresh, pa dinjitet, pa tragjedi,

.....m Episcopus valëvit kondomin plot buburreca të zinj, monopolistët, penguesit e dijes,

penguesit e shpërndarjes.

MONUMENTUM AERE, ETC.

Thoni se jam tepër i vetëdijshëm, Se në petk të krenarisë po kapardisem.

Në vitet e ardhshme askush s'do ta kujtojë buffon, Askush s'do t'i përmendë pjesët e mia të parëndësishme, Do të zhduken hollësitë qesharake, E sa u përket juve, në dhe do të kalbeni, Dhe është pikëpyetje se a do të jetë kalbësira e juaj aq e begatshme

Që mbi varr barin

T'u rrissë.

UDHËZIMET E MËTUTJESHME

Ejani, këngët e mia, t'i shprehim huqet tona të mbrapsh-ta, Ta shprehim smirën tonë ndaj njerëzve me punë të përhershme,

që s'kanë gajje për ordhmëri.

Keni nge, këngët e mia.

Druaj se fundi do t'ju vijë si mos më keq.

Sorrollateni rrugëve,

Shpesh ndaleni nëpër kënde dhe vendndalime të autobusëve,

Vërtet me asgjë s'merreni.

Bile as nuk i vini në dukje cilësítë tona të brendshme; Si mos më keq do t'ju vijë fundi.

E unë?

Gjysmë i shkalluar,

Aq shumë ju kam folur,

gati po ju shoh rrëth meje,

Kafshë të paturpshme, faqezesa, lakuriqe!

Po ju, këngët e mia më të reja, ende s'jeni

Aq të vjetra sa përtë sjellë shumë dërmë;

Do t'ua gjej një palto të gjelbër prej Kine

Të qendisur me dragonj,

Do t'ju gjej pantallona pëlhurë purpuri

Nga shtatorja e Krishtit të vockël në Santa Maria Novella,

Të mos na thonë se nuk kemi shije,

Apo se nuk ka shik në këtë familje.

HETEROTOPIA E ROMANIT SHQIPTAR

Heterotopitë janë vende reale, që gjenden brenda një kulture ekzistuese a një shoqërie të caktuar, dhe duke qenë hapësira tjera, vende jashtë të gjitha vendeve, janë të destinuara për të ndryshuar sisteme kulturore dhe shoqërore

Afrim REXHEPI

Në tekst shqyrtojmë mundësinë e letërsisë së fikcion dhe impaktin e saj në hapësirat e një shoqërie të caktuar. Problematika qëndron në integrimin e letërsisë si hapësirë fikSIONALE, në hapësirën faktike, sepse hapësira letrare është pjesë e realitetit, por edhe është e distancuar nga vetë realiteti. Kjo shpjegohet me faktin që letërsia është fikSION dhe ndikon fuqishëm në proceset politike e kulturore, dhe jo vetëm, është edhe hapësirë fikSIONALE, një hapësirë tjetër që pasqyron e potencializon, me tendencë të transformojë shoqëritë e caktuara. Gjithmonë, në esencën e teksteve letrare, qëndron kategoria e gjasës dhe e mundësisë për ndryshim. Mendojmë që një roman, është heterotopi, është hapësirë tjetër, dhe e ka impaktin e duhur politik dhe kulturor, për ta shfaqur të vërtetëtë në shoqëritë e caktuara. Në librin Universi i fikSIONIT (1988), Thomas Pavel, duke e lidhur përdorimin e ligjërimit logjik për qëllimin e diskursit imaginari me tipologjinë e botës imaginare, theksin faktin që në vend të një semantike të unifikuar, fikSIONI ka nevojë për një tipologji botësh për të përfaqësuar shumëllojshmérinë. "Nëse, nga njëra anë, botërat e gjasave, janë të përcaktuara për të siguruar një model në teorinë e fikSIONIT, nga ana tjetër, nociioni i botës si një metaforë ontologjike për fikSIONIN, mbetet tepër tërheqës...duket e pamundur të identifikojen Ana Karenina, Sherlock Holmes dhe të tjerët, ndryshe nga vetitë që iu atribuohen atyre nga teksti letrar...botërat fikSIONALE posedojnë realitetin e vet, personazhet fiktive mund të ekzistojnë edhe në ndonjë realitet tjetër". (Pavel, 194: 37) Kontakti me filozofinë analitike dhe me semantikën e botës së gjasave, ndryshoi përcaktimet teorike në epokën poststrukturaliste të Ljubomir Dolezel - it. Ishte pasardhës i njëritës nga shkollat teorike - letrare më me ndikim në shek. 20, Shkolla e Pragës, e që pati ndikim të theksuar në zhvillimin e strukturalizmit dhe poststrukturalizmit francez. "Nuk dua të pretendoj se Dolezel-i miratoi të gjitha sugjerimet vendimtare të Shkollës së Pragës (për shembull, ai la mënjanë nociionin thelbësor - funksionin estetik). Megjithatë, pjesa intensive e botës së tij fiktive, është fort e lidhur me metodën e kërkimit stilistik të Shkollës së Pragës". (Bohumil, 2016: 45)

FikSIONI

Në fakt, termi i tij heterokosmika, i shënuar në studimin Heterokosmika. FikSION dhe botërat e gjasave (1988), është rezultat i studimeve që ka bërë në stilistikë, teori letrare dhe naratologji, është sintezë e studimeve për semantikën e narrativës fikSIONALE. Ajo që intrigon, është fakti i teorisë së tij të fikSIONIT që përcaktohet përmes poststrukturalizmit dhe interdisciplinaritetit. Edhe pse, pjesërisht pranon mendimin e Tomas Pavelit që fikSIONI, njëkohësisht është edhe nociion pragmatik, edhe nociion semantik, Dolezel, semantikën e fikSIONIT, e vë në baza të tjerës në raport me pragmën interpretative mimetike, ku semantika e realitetit fizik, kalon në semantikën e botës së gjasës. "Semantika bazohet në përcaktimin ontologjik si vijon të ekzistoshi vërtet, do të thotë të ekzistosh i pavarur nga paraqitja semiotike, të ekzistosh fikSIONALISTI do të thotë të ekzistosh si projekcion semiotik. Në ndonjëren nga sistemet semiotike, si për shembull, letërsia, entitetet fikSIONALE ekzis-

tojnë për shkak të teksteve fikSIONALE". (Dolezel, 1998: 45)

Për të qenë më bindës në interpretimin e teorisë së fikSIONIT të Dolezelit, më poshtë, po shënojmë elementet distinktive të fikSIONIT: Botërat FikSIONALE janë artefakte (poesis); Botërat FikSIONALE janë botëra autonome dje jo imitimë (mimesis); Botërat FikSIONALE mund të janë analoge me realitetin fizik por edhe po aq fantastike sa të janë kundër realitetit fizik; Botërat FikSIONALE letrare janë heterogene për nga makrostrukturë, me semantikë paradigmatiske; Botërat FikSIONALE, ontologjikisht janë të ndryshëm ndaj realitetit fizik, karakterizohen përmes zbrazëtirave ontologjike; Botërat FikSIONALE janë objekte semiotike, ku teksti është medium semiotik që ndërmjetëson midis konstruksionit të autorit dhe rekonstruksionit të lexuesit; Botërat FikSIONALE, janë kategoritë veçanta të teksteve konstruktive, dallojnë nga tekstet deskriptive a përskruese, ku realiteti fizik është ose i vërtetë ose jo i vërtetë. Tekstet fikSIONALE karakterizohen nga një realitet për të cilin nuk mund të thuash që është apo nuk është i vërtetë; gjithmonë, fikSIONIT është referenciale dhe jashtë lidhjeve mirente me realitetin fizik. Umberto Eco mendon që: "Në realitet, botërat e trilluara, janë parazitë të botës aktuale, por ato në fakt, janë "botë të vogla" që kapin pjesën më të madhe të kompetencës sonë për botën aktuale dhe na lejonin të përqendrohem i një botë të kufizuar, të mbyllur, shumë të ngjashme me tonën, por ontologjikisht më të varfër" (Dolezel, 1998: 2).

Sipas teorisë dekonstruktiviste të Fukosë, në secilën kulturë a civilizim, ekzistojnë edhe vende reale dhe efektive, që në përkufizimet e ndryshme përcaktohen si të thuash, si vende të përthyera, vende të marginalizuara brenda një shoqërie a kulture të caktuar, vende antiutopike këto, hapësira tjetër, që Fuko i definon si heterotopi. Në fakt, sipas Fukosë, ç'janë heterotopitë? "Pasqyra është një utopi, pasi është një vend pa vend. Në pasqyrë, e shoh veten atje ku nuk jam, në një hapësirë ireale, që virtualisht hapet pas sipërfaqes. Unë jam atje, ku nuk jam, jam një lloj hixe që më mundëson ta shoh veten aty ku nuk jam, aty ku unë mungoj. E tillë është utopia e pasqyrës. Por është gjithashtu një heterotopi, për aq sa pasqyra ekziston në realitet, me efekte të kundërveprimit, ndaj pozicionit që unë kam. Nga këndvështrimi i pasqyrës, unë zbuloj mungesën time, pasi e shoh veten atje. Duke u nisur nga ky vështrim që është, si të thuash, i drejtuar kah unë, nga hapësira virtuale që është në anën tjetër të xhamit, kthehem drejt vetes. Filloj përsëri të rishkoj veten dhe të plotësohem aty ku jam. Në fakt, pasqyra funksionon si një heterotopi derisa e bën këtë vend që unë zë në momentin e caktur, absolutisht real, i lidhur me të gjithë hapësirën që më rrëthon dhe absolutisht joreal, pasi që përtu perceptuar, duhet të kalohet përmes kësaj pike virtuale që ndodhet atje". (M. Foucault) Pra, heterotopitë, janë vende reale, që gjenden brenda një kulture ekzistuese a një shoqërie të caktuar, dhe duke qenë hapësira tjetër, vende jashtë të gjitha vendeve, janë të destinuara për të ndryshuar sisteme kulturore dhe shoqërore. Kjo tregon edhe kuptimin e dyfishët të heterotopive - hapësirave tjetër, mundësinë e të kuptuarit të hapësirës së letërsisë si hapësirë tjetër, por edhe si një institucion kundërthënës, me potential alternativ. Nga një perspektivë e tillë, sipas konceptit dekonstruktiv të Fukosë, heterotopitë janë hapësira polisemike, dhe



në rapport me hapësirat tjetër, në sistemet shoqërore, janë hapësira paralele. Në diskursin tonë teorik, hapësirën e letërsisë, e kuptojmë si hapësirë me potencë alternative, si hapësirë e mundësive, kurse hapësira letrare / fikSIONALE, është përcaktimi i hapësirës së nejejtë, në formën e një romani.

Hapësira e diskursit fikSIONAL

Në fokusin e interpretimit tonë janë Murat Isaku dhe Kim Mehmeti, romanet e tijë cilëve, për nga kuptimi artistik, për nga dimensioni dhe specifika dominuese e strukturës poetike dhe estetike, janë forma dominuese në letërsinë e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut. Në fakt, po të shënohet a përcaktohet trajktoria e evoluimit të romanit të romansierëve në fjalë, theksohen një evoluirim i poetikës, nga projektimi mimetik (Murat Isaku), deri tek format mitike - simbolike dhe alegorike (Kim Mehmeti). Pra, hapësira e diskursit fikSIONAL, "hapësira tjetër", është fikSIONI - hapësira e gjasës, është mundësia alternative e rendit shoqëror. Në fakt, përcaktojmë fikSIONON (hapësirën letrare) si heterotopi, por edhe si institucion që pasqyron deformimet, tragjizmat dhe potencialet e mundshëm shoqëror.

Në diskursin tonë teorik, romanet e Murat Isaku, i përcaktojmë si hapësira fikSIONALE, si heterotopi që shënojnë ekzistencën e tyre përkufizuese a kundërshtuese nga qendra, janë hapësira fikSIONALE kundërshtuese ndaj gjithçkaje nga qendra. Struktura e hapësirës fikSIONALE, përbëhet nga elementet e mëposhtme: autori i gjithdijshëm fokusohet në hapësirë: Sharri, malet e Sharrit, është hapësirë, ku prehen fatet dhe luhen trageditë më të thella njerëzore. Personazhet e romaneve Plagët, Fatprerët, Rreckajt, Shtjella si për shembull, Kelmend Gajria, Lekë Gajria, Kushtrim Rreckaj, Nikë Rreckaj, Përoska, Gjata, Abo Xhabiri, Sheh Alabini, etj, shprehin fatet tragjike kolektive të popujve, janë figura që shënojnë qëndresë dhe rezistencë. Njëri nga personazhet emblematik të romanit Rreckajt, Kushtrim Rreckaj, i drejtobet të birit me fjalët e madhe është bigorina kur këndohet, por më e madhe bëhet kur i dilet zot. Hapësira fikSIONALE, njëherit, është edhe heterotopi, hapësirë tjetër, hapësirë në marginë dhe gjithnjë në kundërshtim tragjik me qendrën. Arkitektura e hapësirës, përbëhet nga leksemat si: burgjet, zandanet, kulla, shtëpia, djepi, kasolla, guri, konaqet e familjeve të mëdha,

ara, rrugët e fshatit, varrezat, fshati në thellësitë e maleve etj. Gjeografia e fshatrave në thellësitë e maleve, shënon binomin dallues dhe kundërshtues qendër - periferi. Gjeografia imagjinare, shënon mëtë, legjendat, rrëfimet, ëndrrat që kaherë paralajmërojnë fatet e njerëzve dhe popujve. "Duke harmonizuar kohën dhe hapësirën, nëpërmjet studimit të poetikës së Murat Isakut, rigjejmë një univers të gjërë letrar, e artistik, Universi e vendlindjes, gjëjmë Murat Isakun vetë, duke interkomunikuar me botën e artit me botën shqiptare, duke harmonizuar eksperiencat e jashtë (kujtesën, që reflektohet si kujtesë teksti)". (K. Shala). Në fakt, Malësia e Sharrit, në konceptin tonë teorik, është hapësirë tjetër, është hapësirë periferike, që përmes njëfarë sistemi (auto) rregullativ, kundërshton dominimin e qendrës, kundërshton sistemet politike e kulturore të shoqërive të caktuara. Në aspektin e leximit dekonstruktiv e poststrukturalist, Universi i vendlindjes, është hapësirë e kufizuar, është në kontrast me utopinë, është antiutopike, është heterotopi që nuk e kundërshton realitetin fizik, e rrëfen realitetin fizik me të gjitha tragjizmat funksionale në të. Përmes hapësirës së kufizuar - heterotopisë (vendlindja), jo vetëm që përmes rrëfimit tradicional realist, rrëfen përfatim tragjik të një populli i ngujuar në një hapësirë të mbyllur, por dhe përmes një hapësire tjetër - heterotopike, që nxit zgjimin e vetëdijes kolektive, nxit mendimin funksional kritik, për proceset ekzistenciale, shoqërore dhe politike. Në fakt, principi i dytë i heterotopisë, shënon faktin që heterotopitë janë hapësira të destinuara për ndryshim.

Një tjetër shkrimitar, diskursi fikSIONAL i të cililit mund të interpretohet si heterotopi, si hapësirë tjetër, hapësirë periferike, me një sistem autorregulativ e potencial kundrës, dominimet e frikshëm e tragjik të qendrës, është edhe Kim Mehmeti, pdyshim njëri nga romansierët më të spikatur të letërsisë bashkëkohore shqipe. Kritiku Ali Aliu, për veprën e tij shprehet, "Vepra letrare e Kim Mehmetit, ngjizet në ngasje që reflekton bota përreth tij, realiteti i përditshëm, njëkohësisht, ushqyer e përplotësuar nga bota tjetër, ajo e imagjinatës krijuese. Këto dy botë, sikur janë në një përballje, në një përplasje dhe sfidë të përhershme, sidomos në romanet e tij. Njëra, ajo përreth, duke përkufizuar kufijtë e realitetit konkret,

përditshmërinë, njëkohësisht e nxit imagjinatën për atë tjetrën, botën ndryshe dhe të ndryshme, pjesërisht atë të ëndëruar...Kjo, e imagjinuara, vjen për ta universalizuar, për ta bërë të kudo e kurdoherëshme, të mundshme atë, botën konkrete". (A. Aliu) Në fakt, hapësira fiksionale e romaneve të Kim Mehmetit, sendërtohet përmes vetëdijes së autorit të gjithdijshëm e omniprezent. Janë këto heterotopi - hapësira tjera, gjithmonë të marginalizuara e të pozicionuara në periferi, gjithmonë në konflikt të përhershëm me qendrën. Struktura e hapësirës fiksionale, përbëhet nga elementet relacioniste të mëposhtme: autor i gjithdijshëm e ekstradiegjetik, fokusohet në hapësirë: Shkupi që zhvendoset në periferi (Lysiqarët e Shkupit), fshati Suk (Vitet e urithit, Kulla dykatëshe), Reka e Epërmë (Ngjyrat e këtij dheu) etj. i lexojmë si heterotopi fiksionale, janë hapësira tjera këto që pasqyrojnë dramat dhe fatet më tragjike të një populli në mbiqetesë. Njëherit janë hapësira tjera, të marginalizuara, gjithmonë në periferi, që potentializonjë qëndresën e rezistencën për të ruajtur gjuhën, traditën dhe kulturën e të parëve. "A shuhet malli për kullën...braktisja e kullës është mallkim i përjetshëm" - shkruan autor i një fjallë. Arkitektura e hapësirës përbëhet nga leksemat si: kulla, oda e burrave, çardakët, frëngjatë, gjarpri i shtëpisë, varrezat, fshatrat thellë në male etj. Gjeografia e fshatrave thellë në male, shënon hapësirën periferike, heterotopinë - hapësirën tjetër, të marginalizuar nga dominimi i qendrës. Gjeografia imagjinare e

hapësirës, shënon mitet, rrëfimet fantastike dhe fanitjet e Vashëz gjysme zanë, e gjysmë imazh, legjendat e rrëfimet, magjitet dhe fallxhoret, hijet e shpirtrave, zëri i të parëve etj. Karakteristikat a veçoritë e hapësirës lettrare të shënuara më lartë, dhe të definitoria si heterotopi - hapësirë tjetër, shënojnë mundësinë dhe potentialitetin e rizbulimit të asaj që ka qenë në periferi, e margjinalizuar.

"Thjeshtë, nga do që ta ktheje dhe cilindro operacion matematikor ta përdorre, qđo gjë kishte kuptimin e njëshit apo nëntës e që zberthyesit e domethënive të numrave qëmoti e kishin shpjeguar si paralajmërim se në këto hapësira ishin mbyllur nëntë rrathët e një kohe kur njerëzit ishin rrotulluar arreth boshtit të pamundësisë për të dalë nga ngushtica ku jetonin dhe se do të fillonte numërimi i një kohe të re. Në të vërtetë, pas përfundimit të luftërave ballkanike, Shkupi kishte filluar të ikën nga vjetveta, ishte nisur në jug drejt rrëzës së Malit të Krojeve dhe thuaqse donte të shkojë sa më larg lagjeve të lashta, sa më përtëjtë themelove të para nga të cilat kishin lindur të gjitha rrugicat tjera, sa më tej ngrehinave të ngritura aty poshtë mureve të Kalasë, që e kishte ndërtuar Justiniani". (Mehmeti, 2015: 5)

Letërsia si hapësirë tjetër

Në romanet e Kim Mehmetit, lidhen realitet që në aspektin kohor e hapësiror janë të largëta. Shkupi Dardan, Shkupi 1990, Shkupi i 1912, Lysiqarët e Bagdatit, Lysiqarët e Kosovës, Lysiqarët e Tetovës, të

Dibrës e të Çamërisë, kuptimi i shenjave në gurët e Urës së Gurit dhe të Kalasë, interpretimi i shenjave në hartat e ndryshme për strukturën urbanistike të Shkupit, Burmali Xhamia e Çarshia e madhe etj. Në fakt, në strukturën e tekstit romanesh, koha dhe hapësira nuk janë entitetë të ndara, por funksionojnë brenda një kontinumi hapësiror - kohor. Lidhja e kohërave dhe vendeve të largëta përmes sagave të Lysiqarëve, shënon hapësirën e një bote të humbur, përmes legjendave, miteve dhe imaginatës. Pra, heterotopia fiksionale, zbulon të vërtetën e sistemeve shoqërore, e njëkohësisht, e plotëson realitetin. Kemi bindjen që romanin Lysiqarët, duke e definuar edhe si heterotopi, edhe si institucion, mbëthen në vete impulse politike, duke mos e dobësuar edhe impulsin ideologjik. Prinicipi i dytë i heterotopisë, shënon faktin që heterotopitë janë të destinuara për ndryshime.

Romanet paradigmatiske Rrengu dhe Lysiqarët, vendosin në një pozicion specifik në raport me realitetin faktik. Brenda diskurrit dhe hapësirës, zhvillojnë atë tezë potenciale, që në hapësirën e realitetit faktik nuk ka qenë e mundur të krijohet. Pra, ky është roli institucional i romaneve paradigmatiske, romanet si heterotopi, që përjashtojnë heterogjinitetin e shoqërisë, në funksion të homogjinitetit të saj. Romanet paradigmatiske, shënojnë edhe një fakt, faktin që natyra e letërsisë është e dyfishtë, është edhe fiksionale, që përdor materialin faktik, e njëkohësisht, në hapësirën shoqërore, funksionon si institucion, si një lloj mekanizmi (auto) rregullative.

lativ i deformimeve shoqërore dhe politike.

Duke u bazuar në paradigmat teorike të fiksionit (Th. Pavel dhe L. Dolezel), tekstet fiksionale (romanet e Murat Isakut dhe të Kim Mehmetit), i kemi vleruar Jashtë kriterit të së vërtetës, në fakt i kemi përcaktuar si fiksione, shprehjet e të cilave, nuk janë as të vërteta e as jo të vërteta. Por, është edhe një fakt i pambuheshëm që nuk mund të ketë letërsi Jashtë realitetit fizik, ajo (pra, letërsia), është pjesë e hapësirës kulturore të shoqërive të caktuar. Një përcaktim i tillë teorik, shënon faktin që letërsia është heterotopike, është një hapësirë tjetër që ngërthen në vete mekanizmat e sistemeve (auto) irregulitative, të favorshme edhe për shoqëritë e caktuara. Përcaktimi i letërsisë si heterotopi, është e njohur në paradigmat teorike, ajo fiksionon si institucion në rizbulimin e antagonizmave të shoqërive. Veprat e romansierëve më të mirë shqiptar në Maqedoninë e Veriut, siç janë Murat Isaku dhe Kim Mehmeti, i kemi analizuar në mënyrë që natyra e tyre letrare është bifunksionale, në kuptimin që përdor jo vetëm materialin faktik a parafurgacionin për ta shndërruar në fiksion, por edhe funksionalizimin e potentialit të tyre institucional, në kthimin e rendit dhe vlerave të një botë të degraduar dhe skajshmërisht të marginalizuar. Fiksionet romaneske të shkrimitarëve shqiptar, në diskursin tonë interpretativ, janë hapësira fiksionale, janë heterotopi që rizbulojnë a pasqyrojnë hapësira tjera "të rregullta e të përkryera, si kanuni" (Kim Mehmeti), por gjithmonë në antagonizëm tragjik me hapësirën keq të organizuar, kaotike dhe dominuese.

Dysia e siluetës femërore në poezinë e Ilirjana Sulkuqit

METAFORA E HIJES

Lirizmi i theksuar, mirësia dhe dashuria multidimensionale, pasqyron subjektivitetin e mimesit (realitetit), që qartësojnë mesazhin e poetës ndaj lexuesit, jo vetëm duke drituar feminizmin e saj, por identitetin poetik unik të Sulkuqit

Emrije KROSI

Për të kuptuar dhe lexuar si duhet një poezi të shkruar nga në femër, nuk rreftojnë vetëm leximet e saj të mëparshme apo edhe leximet e shumë shkrimeve femërore, që në kuptimin më të gjërë, përvëce përshtatshmrësë kemi edhe transformimin me natyren femërore, që kulturalisht shkrimet feministe/femërore, përvëce diferençave gjinore (maskull/femër) si modele letrare, ndërtohen mbi bazën e eksperiencës të tyre femërore, (Boumelha: 1982), jo vetëm si narrative femërore, por edhe si shumësi leximesh dhe interpretimesh poetike. Poezia "Unë me hijet e mia-siluetë perëndie", (Sulkuqi: 2021), në trajtën e saj të dysisë (unë/hija) apo (Ilirjana/shemra) monologon me hijen, që nuk nënkupton atë lloj metafizikë tradicionale, që nënkupton përcaktueshmërinë dhe paqartësisë si shënjues konotativ të fjalëve unë/hija.

Monologun tim,
përgjatë hapave të shëtitjeve
në orët e ditës
e shoqërojnë,
pa lejen time,
Hijet e mia -
të shkurtra, të gjata ...
sipas orës diellore pa eklipse.
Hijet e mia


**ma bëjnë monologun - dialog
duke u grindur**
me pjesën e padukshme
të vetes sime, me apo pa shkak...
Hijet e mia -
pa zhurmë,
pa konture bukurie.
Vetëm Siluetë grafike
prej Perëndie...
Unë dhe Hijet e mia -
një tango e pa kërcyer
në asnjë skenë të botës së rrreme.
Kurriz më kurriz me njëra -
tjetrën,
me të njëjtën Frymë,
jetojmë
si dy shemra.

Me të gjitha proceset që prodhojnë poezia dhe vetë të menduarit fillon të duket sikur kërkon jo vetëm mendim, por edhe vizualitetin se "mendimi lëviz", (Ferber: 1985) brenda dhe Jashtë literalizmit, në vargjet: monologun tim, përgjatë hapave të shëtitjeve/në orët e ditës/e shoqërojnë./pa lejen time./Hijet e mia - /të shkurtra, të gjata .../sipas orës diellore pa eklipse. Metafora e hijes, projektion një postmodrenizëm, më përtëj përpjekjeve për të kuptuar, si një çështje të përvojës së dikujt (të poetës ose lexuesit) dhe jo si qëllimi i dikujt, se interpretimi është çështje reagimi sesa kuptimi. Dysia vazhdon edhe në vargjet: hijet e mia/ma bëjnë monologun -

dialog/duke u grindur/me pjesën e padukshme/të vetes sime, me apo pa shkak.... Jo një hije, por disa (hije dhe dyshimet tona) që lëvizin fitjet e një lloj "ekilibri shpirtëror" midis së mirës dhe së keqes për një teoritë të njohje së vetes dhe "kontradiktat" e asaj pjesë të padukshme, asaj që ne e quajmë ose Djalli ose Engjelli i fshehur njerëzor, në dysinë tonë têrhiqet dhe zmbrapset, duke ndërlidhur arsyen dhe energjinë, dashurinë dhe urrejtjen, si pjesë e nënvetëdijes të ekzistencës njerëzore apo të cogito-s shpirtëre (Sarri: 2011). Njëjtësimi i unit poetik autorial me përsiatjet e metaforës emërorë: hijet e mia (shumës), imazhi i vetes i pasqyruar ne formën e hijes, si materie e padukshme (jashtë fizikës), ku femërroja është aq këmbëngulëse. Fjalët në poezi janë të lidhura me dukuritë shkakore jo thjesht një "letraritet", por trope të metaforës së pasqyrimit të vetes përtëj vettvetes (Bloom: 1975). Në vargjet: hijet e mia - pa zhurmë,/pa konture bukurie./Vetëm Siluetë grafike/prej Perëndie.../Unë dhe Hijet e mia - një tango e pa kërcyer/në asnjë skenë të botës së rrreme, struktura aq e thellë e një dimensioni simbolik, (Terziu: 2014) duke kërcyer me hijen [përsëritet katër herësidomos nén "petkun" e reticencave, është si frymëmarrje/-frymëdhënie në pauzat e vallëzimit me një të verbër tek filmi "Aromë gruaje" (një lojë imazhi me kërcimin e Al Paçinos), është edhe imazhi i Ilirjanës (poetja luan me imazhet poetike). Asgjësimi i hijes është njëjtësuar me "asgjësimin e shpirtit" që bëhet burimi kryesor i patosit lirik në poezi, në vargjet: kurriz më kurriz me njëra - tjetrën./me të njëjtën Frymë./jetojmë/si dy shemra (FGJSH: 2006) [(kuptimi i fjalës: shém/ér,-ra emër i gjinisë femërore; numri shumës; -ra(t) 1. gruaja e dytë e një burri kundrejt gruas së parë që rron me të: janë shemra)]. Metoda dhe intuita zëvendëson qëllimin, duke ndjekur një teori ekspresioniste dhe konstruktive, nëpërmjet asgjësimit të vetë postmodernizmit që decentralizon autoritetin dhe përqafon pluralizmin, (Ashton: 2005), duke inkurajuar një pikë "panoptike" ose të shumanshme të pamjes. Ajo e ushqen shpirti me ndjesi të reja, me larushi temash plot shqetësimë jetësore, nëpërmjet temperamentit impulsiv, ka krijuar një poetikë të sajën, sepse semantika e fjalëve ka tejhpuar (tej)përtëjt shigjetën e fatit, me nota platonike dhe përmasa universale, (blogspot: 2008). Lirizmi i theksuar, mirësia dhe dashuria multidimensionale, pasqyron subjektivitetin e mimesit (realitetit), që qartësojnë mesazhin e poetës ndaj lexuesit, jo vetëm duke drituar feminizmin e saj, por identitetin poetik unik të Ilirjana Sulkuqit.

RIMË E TRETUN

Poezia "Rimë e tretun" është një krijesë mjaft delikate, por e koklavitur. Pasi nis me një sentencë, të pakthyeshme, tregon një histori që shoqëron sentencën, jep një vijimshmëri gati absurde dhe shoqëron vizionin e këtij absurditeti, por...



(Hamdi) Erjon MUÇA

Teksa lexoja për disatën herë poezinë e Migjenit, "Rimë e tretun", herën e fundit, kjo poezi më solli në mendje poezinë e Blake-ut, "Plisi dhe guri i zallit". Migjeni është një nga poetët tanë, në mos, poeti ynë më i habitshëm. Jo vetëm sepse shkroi çka nuk që shkruar më parë në Shqipëri, por edhe sepse përdori në mënyrë mjaft të veçantë artin e fjalës; nganjëherë të duket sikur brenda një poezia janë shkrirë jo vetëm zhanre të ndryshme letrare, por edhe këndvështrime të ndryshme ngjarjesh, njëherësh. Pra sikur kemi dy individë që shohin një ngjarje nga këndvështrime të ndryshme dhe e tregojnë njëkohësisht; si koncept ky i përket deri në një farë mënyre naivëve. Vetëm se ai përdor mjaft metafora hermetike në brendësi të këtyre koncepteve. Ndoj, në vështrim të parë poezitë e Migjenit, kanë një koklavite rrëmbyses; kjo, sipas profesor Arshi Pipës, ishte një lloj defekti i poeziave të Migjenit, shkaktuar nga ndryshimet e gjendjes fizike; meqë Migjeni vuante nga tuberkulozi...

Poezia "Rimë e tretun" është një krijesë mjaft delikate, por e koklavitur. Pasi nis me një sentencë, të pakthyeshme, tregon një histori që shoqëron sentencën, jep një vijimshmëri gati absurde dhe shoqëron vizionin e këtij absurditeti, por...

Jeta i kaloi si një gotë shamanje.

Fjala e tretun në dialektin shkodran ka dy kuptime, gati të aferta në thelb, por diametralisht të largëta në konceptim kur përdoren. Në Shkodër e tretur do të thotë e hedhur, por nëse tha: e kam tret, ka të bëjë me një veprim të qëllimshëm, me vetëdije të plotë. Vetëm se mund edhe të thonë: mos e kam tret pa dashje! Pra, është një veprim jo i vetëdijshëm, flitet për diçka që nuk ekziston më, por në rastin e parë askujt nuk i vjen keq ndërsa për të dytin, ekzekutuesi i tretjes ndihet fajtor për veprimin e tij. Madje, me një vështrim më të irrtë, fjala tretë është shumë më thellë se hedh; të jep përshtyp-

jen e shpërbërjes fizike...

Pra, kur e lidh me titullin, në të dyja versionet, kemi të bëjmë me hedhjen (shpërbërjen e materies) e jetës shpejt si të ishte një gotë shamanje, por me versionin e dytë del në pa edhe më, dhunshmëria psikologjike e këtij vargu sentencial. Pa dashur jetën e treti si një gotë shamanje. Ia ndjeu shijen, freskinë, iu përndez paksa qellza nga bulëzat e gazta, por gjithçka përfundoi shpejt; i la në gojë shije mëdyshje. Jeta i shijoi, por nuk...
Po t'i kish vënë titullin "Tretun" dhe ta kish lënë vetëm me këtë varg, Migjeni do të bënte atë që bëri Ungareti në Itali, poeinë më të shkurtër; Poëzia e Ungaretit titullohet "Mëngjes" dhe ka vetëm këto fjalë: Ndriçohem me pafundësi...

Nët i çoi nér shtrëtë mbi gjitë grave, të cilat e deshtën fort e ma fort për pare sesa për kafshimin e tij të dhambëve. dhe syparia ra...
Protagonisti vdiq...

Kjo strofë në parje të parë duket sikur flet shkoqur, e pikërisht tek ky eksplicit qëndron metafora e mrekullueshme. Në botën moderne, mondane, défrimi ndryshe quhet edhe "jetë nate", shtrati është vizioni që njeriu i jep kënaqësisë paraçore dhe kjo shoqërohet me: gjitë grave; pra në zemër të epshit më të dëshiruar nga qenia humane. Por, kënaqësitë, veset, epshet nuk ndjekin njeriu e varfër; ato ndjekin atë që ka mundësi t'i blejë këto kënaqësi; Migjeni nuk na jep vetëm vizionin e një qenie që është gjithnjë në kërkim të kënaqësisë, por edhe për matematizmin që shoqëron jetën e njeriut; njeriu është më i lidhur mbas fizikes se morales. Pra, kënaqësitë kërkijnë më tepër pasurinë se sa njeriun; Kafshimi i dhambëve; duket sikur kërkon të tregojë lidhjen tonë me botën shtazore. Kënaqësitë e kësaj jete nuk blihen me forcë, por me para; bota njerëzore ka vendosur një çmim për gjithçka! Gjithçka na rrëthon, me atësi njerëzore nuk është aspak reale; kemi të bëjmë me një tragjikomedi groteske. Në momentin që njeriu

vdes, përfundon (u tret; u shpërbë, u pluhurizua) edhe drama komike në të cilën ai aktroi si protagonist kryesor; miliarda protagonistë e miliarda komedi dramatike që përbënë tragjikomedinë e madhe që luhet, pambarëmisht mbi këtë planet. Sa tallëse është gjithë kjo; por kjo ka një lidhje thaujse natyrale me Rezignatën; sa e shitur. Nuk ka post morturm, post scriptum, pasi ulet sipari gjithçka tretet; përgjithnjë...

Por nuk vdes shampannja!

Nuk vdes dëshira! Nuk vdes vesi, epshi; gjithçka që tërheq njeriun, prej mishit, mbi këtë planet majmunësh. Mos e merrni për keq epitetin, e kisha fjalën për kopjacërinë e qenies njerëzore; si thuhet ndryshe: kopjac si majmun. Nuk vdes dëshira e njeriut për të jetuar, défryer duke kopjuar défrimet e vjetra me emra të rinj! Tretet vetëm njeri...

U lindën milionet
me miliarda dëshira,
kuj t'i lëshohet radha
kur nuk ka batallo?

U shtua populisia njerëzore mbi planet, duke i zënë vendin brezave të tretun, por me një handikap, dëshirat dhe veste u shtuan jo në proporcione populisinë. Duke ndjekur vargjet e gjenien kupton se njerëzit nuk kanë vetëm dëshirat dhe veste e veta, por edhe ato të paraardhësve të tretur. Askush nuk është keq përmëditime, të gjithë janë të etur për shkrehje endjesh të pafundime. Jemi përballë një kataklizme psikologjike, globale; njeriu është i marr peng nga dëshirat e paplotësuara, ato të mbetur pezull. Ato po e mbysin ekzistencën e qenies njerëzore. Diçka të përafert ka trajtuar edhe Honore de Balzac në romanin e tij "Melmoth Pajtuesi". Ky roman bashkë me romanin "Vajza me sy të artë" dhe "Lëkura e Shagrenit" po të Balzak-ut, janë librat e parë të rrymës dekadentiste, hapja e kësaj epoke që u mbyll vetëm në prag të Luftës së Dytë Botërore. Pra, Balzaku trajton dëshirat e njerëzve dhe me anë të një shpirti të lig, që futej në shpirrat e njerëzve, ai shpreh

degradimin e qenies njerëzore; na jep brishtësinë e saj edhe pse e ndërtuar me një koklavite marramendëse. Edhe Migjeni, me anë të kësaj poezie, trajton hutimin e madh që përjeton qenia e tretun njerëzore.

Por do të ketë Karnera
dhe do ketë poetën,
gjithashtu edhe priftën.

E mrekullueshme, gjeniale, është mënyra se si Migjeni kërkon dhe gjen fjalë për të paraqitur sa më mirë imazhin që a në mendie. Karnera: në italisht do të thotë njëri i mbushur fizikisht me forcë të jashtëzakonshme. Me pak fjalë, egoist, prepotent. Pra, do të ketë edhe egoistë prepotent, që kërkojnë me çdo kusht të kenë supremaci mbi gjithçka. Do të ketë edhe njerëz naiv, poetë, që mundohen të gjejnë me çdo kusht dritëhijet e jetës. Njerëz që vuajnë shpirtërisht, më tepër nga çmund të përballojnë. Njerëz, viktima, të mendimeve, ndjesive që nuk u burojnë vetëm nga brendësia e qenies së tyre, por u vijnë edhe nga hapësirat e pamata të evolucionit njerëzor. Do të ketë edhe Priftën!

Migjeni me gjasë kishte fobi nga veshja e pushtetshme, që njeriu dëshiron me forcë. Më tepër se çdo veshje, kjo fobi qëndronte përballë teologëve; të veshur me një pushtet virtual, okult, të pakonceptueshëm si pushtet, për gjenitë, por të domosdoshëm, deri në tretje, për qenien njerëzore. Me fjalën priftën, ai do të nënkuptojë oportunistin. Sepse vetëm një oportunist ka nevojë të vishet me petka pushteti fiktiv; pushtet që i frikëson njerëzit me tepër se çdo lloj pushteti. Një pushtet që u ka gllabëruar jo vetëm pasuritë njerëzve, por edhe ekzistencën.

Nuk vendosi profesorë, shkencëtarë, inxhinierë, apo doktorë, por priftën; figura e kontrollit psikologjik mbi masën. Këtë figurë mund ta ndërroni me lloje të tjera figurash, demagogjike, groteske, krijuar nga e tretura njerëzi. Pra kemi egoistë optimistë, që janë viktimat e përhershme të vesit dhe kërkuesit e pashtershëm të kënaqësisë, por që askur-rë nuk e pranojnë. Pesimistët; kërkuesit e rrugës cilurose të njerëzimit nga kthethrat e tretjes. Dhe oportunistët; klasa në minorancë që komandon, shtyp, tret nëpër labirinte të përbindshme kontrolli, shumicën e popullatës së kësaj bote.

Prifti ka për të thanë:

Ku do të shkojë
ai që e çoi
jetën si një gotë shamanje
e ku ai me të thyeme dhambë?

Këtu poeti sheh têrësinë e tablosë paradosale njerëzore dhe me shpoti, duke i dhënë tone pyetje, evidenton defektet në kompozimin këtij kuadri. Kuadër i gjallë që lëviz nëpër shekuj, që ndryshon aktor, personazhe, por me një libret të njëjtë. Skenografia ndryshon, egoistët (Karnera) bëhen gjithnjë e më grykës. Poetët (naivët pesimistë) ndryshojnë fjalët dhe tonalitetin e lëngimeve; diçka e ndryshojnë të paktën. Ndërsa priftën (opportunistët) kanë gjetur argumentin e duhur, ka mijëra vjet që argumenti mbetet i pandryshuar, e ndoshta kushedi përsa mijëra vjet do mbetet tillë; ndoshta deri ditën kur bota njerëzore të jet e tretun brenda pikave të errëta të ndërgjegjes së vet...


Jeta i kaloi si një gotë shamanje.

Nett i çoi nér shtrëtë mbi gjitë grave, të cilat e deshtën fort e ma fort për pare sesa për kafshimin e tij të dhambëve. dhe syparia ra...

Protagonisti vdiq...

GRUAJA QË JETON MIDIS JETËS DHE VDEKJES

(Përkitazi me në romanin "Gruaja haluçinante" të shkrimtares Mimoza Ahmeti)



Alma ZENELLARI

"Gruaja haluçinante" më ka dhënë kënaqësinë e madhe të të lexuarit. E kam shijuar çdo fjalë, çdo paragraf. Aq sa u jam rikthyer sërisht, për t'i mbartur thellë në vetëdijen time. Kam ndjerë një tërheqje të tillë që gishtat e mi e kishin të vështirë të mbyllnin kapakët e librit. Përkundrazi, ashtu si sytë ata nxitonin të kthenin me ngutje faqen pasardhëse. Ishte një shtyje e këndshme brenda rrjedhës logjike të fjalëve. Fjalë të ujdisura me kujdes, të

pjesa e dytë e fjalisë nuk merr përsipër të shpideoj pjesën e parë të asaj fjalie, siç ndodh shpesh me autorët e letërsisë moderne, apo përfaqësues të të ashtuquajturit "përrroi psikik". Përkundrazi, fjalitë rrjedhin këndshëm me një ritëm të admirueshëm. Dhe kjo e zbukuron rrëfimin.

Fjalët janë si burimi, thotë autorja, por etja e lind burimën dhe prej aty rritet ajo energji e madhe jetësore që na ngazellen. Mjafton të ndjekësh ritmin dallgëzues dhe ndjen përhithjen, plotëninë. Dhe fjalët në librin e Mimoze janë si kjo rrjedhë. Aq sa

kursyera, të paqtë, të çliruara nga teprimet, nga lidhëza parazite që nuk bëjnë tjetër veçse e rëndojnë shkrimin dhe e ngadalësojnë ritmin e të lexuarit. E kam dashur gjithherë poezinë e Mimoza Ahmetit, stilin e veçantë të të shkruarit të papengesë, të çlirët dhe imponues, sepse përmua, të frymosh përmes fjalëve, të luash me fjalën pa e dëmtuar kuptimin e mirëfilltë të saj, kjo sështë veçse inteligencë.

Në përgjithësi libri është ngritur mbi fjalë të rregullta, gati me një prerje të rregullt bisturie. Aspak të gjata për t'u lodhur lexuesin, edhe pse dihet se autorja nuk është nisur ta ketë qëllim në vetvete këtë fakt, përderisa çdo fjalë ka një rrjedhshmëri burimore për t'u lëvduar.

E megjithatë edhe kur ka raste fjalish të gjata, asnjëherë nuk merr përsipër të shpideoj pjesën e parë të asaj fjalie, siç ndodh shpesh me autorët e letërsisë moderne, apo përfaqësues të të ashtuquajturit "përrroi psikik". Përkundrazi, fjalitë rrjedhin këndshëm me një ritëm të admirueshëm. Dhe kjo e zbukuron rrëfimin.

të kriohet përshtypja se autorja nuk vuani shumë për të na quditur me ngjarjet që kaplojnë jetën e kësaj gruaje apo gjendjet shpirtërore e shpërftyrimin psikik të saj. Kjo gjuhë e artë metaforike që gjallë brenda këtij libri, është mënyra më e veçantë që dallon këtë shkrimtare, e cila duket se shkruan përmjaqësimi kast të caktuar, të veçantë lexuesish të përzgjedhur.

"Gruaja haluçinante" nuk ka një emër të veçantë, ajo është thjesht gruaja që jeton midis dy gjendjeve të jetës dhe vdekjes që i shkaktojnë ankth, frikë, paqen-drueshmëri. Dhe si e tillë, ajo rreket të nxitojë të dalë nga këto gjendje. Kapet pas dëshirës përmjaqësimi kast të caktuar, e ideve tronditës të saj. "Gruaja haluçinante" na tërheq me një delikatesë të bukur, naive, pavarësisht gjendjes së saj ankthioze. Por, në mënyrë të habitshme nuk e lodh lexuesin.

Dhe kjo është padyshim merita e jashtëzakonshme e autoreve që edhe nëse personazhi i saj vuani nga depresioni, përsëri ajo nuk e zhyt lexuesin në atmosferën mbytëse gri, përkundrazi protagonistja vuajtjen e saj të brendshme të ashtuquajturin shformim psikik që përjeton, përpinqet ta zbusë ndjeshëm me forcën e vullnetit të saj. Duke dashur t'i bashkëngjisë jetës, nuanca drite, pikërisht atë rezatim që i kish munguar. Duke dashur të largojë atë realitet rutinor të ashpër që mbyt shpesh jetët tona, kërkon të dalë nga ajo gjendje e kithët që zapton gjithëherë qenien njerëzore, siç është përshtatshmëria e detyruar apo me fjalë të tjera rënia në rutinën vrastare të pandryshueshmërisë. Pikërisht kjo umungon njerëzve normal, thotë protagonistja me gjuhën dhe mendjen e autoreve. Njerëzit nuk arrijnë të bëjnë "ndryshimin", duke e lënë jetën ashtu më kot të rrjedhë apo të pasqyrohet e ngathët e palëvizhme në një pasqyrë pasive. Njerëzit, thotë autorja, nuk e shohin njeri tjetrin në sy, e shmanqin këtë fakt. Përsë? Kjo, sepse ata kanë frikë nga pasqyrimi i vvetvetes në sytë e tjetrit, prandaj dhe e keqia mbetet aty. Ata nuk e dinë (ndoshta dhe e dinë) se jeta e tyre buron pikërisht nga ky lloj reflektimi.

Autorja e njeh mjaft mire gjendjen psikologjike të personazhit, "simptomat" e

saj. Ajo e vendos këtë grua brenda këtij rrëfimi delikat për ta njohur, për t'i dhënë asaj sharmin e të qenit një grua e veshur me zgjuarsi, kuptueshmëri dhe guxim (pavarësisht halucinacioneve të saj), duke trazuar ndjeshëm emocionet, ndjeshëmritë tonë, duke na bërë alert në kërkim të disa përgjigjeve të fofta, përballë asaj shumësie pyetjesh që e kanë lodhur tashmë njeriu. Ç'ka përtet trupit, përtet shqisave? Sa mund të zgjasë dhe sa mund të ndikojë dhimbja në nocionin kohë? Përsë njerëzit e kanë luksin për të jetuar, shijuar gjithçka nga perceptime që përthyhen brenda vetëdijes? A është luks edhe vdekja? Apo është pragu i panjohur i kalimit të jetës në një tjetër dimension hapësinor të pakonceptueshmë nga njerëzorët?

Ndonjëherë të kriohet ideja se kjo grua e paemrë është vet autorja që ka prirjen për të na zhytur nëpër rreshta për ta zhbiriluar atë vet nëse do mundeshim, botën e saj mes vëtmisë dhe ankthit. Dhe halucinacionet nuk janë veçse një kurth i saj për të na afruar dhe larguar kur ajo e sheh të domosdoshme. Ajo është gruaja që duket sikur jeton jashtë disa dimensioneve kohore, jashtë disa sistemeve kohore dhe që përpinqet t'i shpërfill. Shpesh herë pëson një ndarje të trupit nga shpirti, një shpirt i sposuar nga trupi. Dhe si e tillë gjendet në këtë dyluftim të qenies nga mosqenia, duke u rrokullisur aty ku vdes çdo çast e nuk ka duk as vdekja.

Vetmja që konsumon shpirtin njerëzor është temë e prekshme e lëvruar nga shumë autorë, sepse vetmja e ndjek njeriun hap pas hapi, i cili pavarësisht gjithëkajë e gjen veten sërisht në një pikënjëse të re. Koha përsëritet. "Grua haluçinante" dhe vetmja e saj, kjo dhimbje rrëqethëse e patrjtë, por që ngulet thellë në mish dhe tru.

"Gruaja haluçinante" është një rrëfim që të bën për vete, të josh dhe të shtyn në një pritje të re librash të poetes Mimoza Ahmeti, duke ruajtur të njëjtën lartësi. Një libër që edhe pasi e ke lexuar, ke dëshirë t'u rikthehesh paragrafëve që të kanë pëlqyer, fjalëve që të kanë rrëqethur, befasuar.

"Fjala, kjo shpikje e madhe e njeriut".

Film

SËMUNDJET QË PREKIN SHKRIMTARET

Filmat në fjalë janë një simbolikë e shumë statistikave, intervistave dhe rrëfimeve individuale të kryeredaktorëve, redaktorëve, profesorëve, të cilët tregojnë se shkrimtaret gra përballen me sfida të shumëfishta gjatë rrugëtimit të tyre

Nada DOSTI

Njëra quhet Valeria tjetra Rakela, të dyja spanjolle. Njëra jeton në Madrid, tjetra në Barcelonë, dhe të dyja janë gra noveliste. Të dyja vuajnë nga sëmundje të zakonshme që i prekin shkrimtarët, veçanërisht gratë.

E para vuani nga sindroma e mashtrues (impostor syndrome). Teksa përpinqet të shkruajë novelën e saj të parë, duke e gjetur veten nën presionin përtia dorëzuar shtëpisë botuese draftin e parë të librit, ajo goditet nga fenomeni që

njihet si bllokimi i një shkrimtarë. Gjendje e cila kaplon çdo lloj shkrimtarë të ri ose të vjetër, qoftë në moshë qoftë në përvjë, ka të bëjë me një bllokim të krijuar të në atë lloj nivelit sa duket sikur asgjë nuk e frymëzon më, dhe pavarësisht çdo përpjekje përtë zhgaravat ndonjë fjalë, letra (ose faqja e wordit) mbetet bosh. Të hequrit dorë nga një punë e mërzitshme, e cila nuk i fal lumturi, kthehet në një nga shkaqet që Valeria të rifitojë frymëzimin, duke ndërruar stilin e mënyrë të rrëfyeri, arrin të shërohet dhe nga sëmundja vetëdiagnistikuese e

sindromës së mashtruesit, duke arritur që jo vetëm të publikojë novelën e parë, por që të korri aq shumë sukses, saqë shtëpiat botuese arrin ta joshë me propozimin e një bashkëpunimi të ri. Kur arrin ta shohë librin e saj në duar të lexuesve të ndryshëm në përditshmërinë që e rrëthon dhe ftesa përtë folur në një universitet përrugëtimin e saj deri te botimi i librit, janë ndërsa skenat që flasin përmërrën më të madhe të një shkrimtarë.

E dyta, Rakela pra, vuani nga pasiguria ose kompleksi i vetëbesimit të ulët që e ndalon atë përtë ndarë shkrimet e saja

me të tjerët. Filmi hapet me një skenë, e cila tregon shumë për natyrën e saj si shkrimtare e re dhe e ndrojtur: një kolege rrëmben fletën e saj të shukur dhe lexon pa zë, ndërsa profesori pyet nëse dëshiron ta lexojë me zë, duke e ndarë shkrimin e saj me të tjerët, ajo heziton, duke thënë: "Nuk është asgjë".

Të rrëfesh një ngjarja nuk mjafton vetëm të dish të shkruash, por duhet të jesh e pajisur edhe me guximin përtë rrëfyer atë, shprehet ajo.

Rakela është një studente e gjuhës dhe letërsisë, e cila herë pas here hutohet nga

sfidat e moshës, përsëri arrin të përfundojë novelën e saj të parë, e megjithatë goditet nga pasiguria dhe mungesa e besimit te vetja. Pavarësisht se profesoresha e saj e letërsisë i propozon që ta dërgojë dosjen e saj një shtëpie botuese, duke përdorur atë vetë si referencë, Rakela nuk arrin ta shtypë butonin "Dërgo". Në vend të saj, këtë e bën një mik i ngushtë dhe ia dërgon dosjen shtëpisë botuese dhe propozimini për botim pranohet me sukses.

Filmat në fjalë janë një simbolikë e shumë statistikave, intervistave dhe

rrëfimeve individuale të kryeredaktorëve, redaktorëve, profesorë të shkrimtarisë, të cilët tregojnë se shkrimtaret gra përballen me sfida të shumëfishita gjatë rrugëtimit të tyre. Shumica prej tyre nuk kanë të bëjnë vetëm me faktin se nuk merren seriozisht apo nuk vlerësohen mjaftueshmë aq sa dhe meshkujt shkrimtarë, por edhe me faktin se paragjykime të shumta dhe një sistem i tërë ka bërë që të kenë më pak besim tek vetja, por mbi të gjitha të pajisen me një mungesë guximi, i cili i pengon ato të përparojnë në rrugëtimin e tyre si shkrimtarë.



Botime

KOPSHTARI I ËNDRRAVE - NJË HIMN PËR LIBRIN DHE LEXIMIN

Mbi librin "Kopshtari i ëndrrave", autor: Claudio Gobbetti, ilustrimet dhe dizajni: Diyana Nikolova, botuar nga Sh. B. Mediaprint, Tiranë 2021, përkthyer nga Arta Marku

Xhahid BUSHATI

CLAUDIO GOBBETTI u lind në Foligno, Itali. U diplomua për Letërsi dhe Filozofi në Universitetin e Urbinos. Adoleshencën e jetoi në Pesaro. Pas diplomimit, u transferua në Milano për të ndjekur një master në shkrimin krijues. Ai ka punuar për agjencit të mëdha reklamash, duke fituar çmime kombëtare dhe ndërkombëtare. Aktualisht është autor televizioni dhe profesor në Akademinë e Re të Arteve të Bukura në Milano. Vitet e fundit ka krijuar një pasion për librin përfëmijë. Librat e tij janë përkthyer në Francë, Angli, Spanjë, Kanada, Kinë, Turqi, Tajlandë, Rusi, Amerikë e Jugut, Shqipëri, Rumani, Slovaki, Vietnam, Japoni dhe Greqi.

Në një rruzull me "një emër të bukur që s'ia di kush" jeton një burrë shumë i vjetër, aq i vjetër sa nuk i kujtohet as moshë e vërtetë. Mban një kapele qesharake, ka një mjekër të gjatë e të bardhë, një palë syze dhe shkruan mbi një fletë me një makinë të zhurmshme shkrimi me taste të prishura. Pasi përfundoi së shkruari fletën, burri niset në kërkim të vendit të përkryer ku e mbjell dhe pastaj rikthehet që të përkujdeset për të. Nga ajo faqe e mbjellë, pas përkujdesjeve të gjata mbin një pemë shumë e bukur me trung të trashë dhe kurorë të dendur, që ka fletë në vend të gjethive. Kur fletët piqen, burri nis t'i vjelë, i bën pirg me kujdes, i lumtur nga rezultatet e një pune të gjatë. Më në fund i qep me dorë njëra pas tjetrës derisa bëhen libra dhe i le të lirë që të fluturojnë jashtë drifteve së shtëpisë. Librat bëjnë një rrugë shumë të gjatë, mbi dete e shkretëtira, ditën e natën dhe, në fund arrijnë në një bibliotekë, ku çlodhen mes historive të tjera që lexuesit mund të zgjedhin.

Një libër i ilustruar bukur plot magji, shije dhe fantazi nga Diyana Nikolova. Ajo ka lindur në Bullgari. Ka punuar si grafiste dhe drejtuese arti për disa

agjenci publicitare të rëndësishme. I është kushtuar ilustrimeve përfëmijë.

Ky libër për problematikën që mbart, përmisionin që përçon, është i rëndësishëm, jetik dhe jeton sa të ketë frymë bota. Vogëlushët nuk duhet ta humbasin këtë libër të vyer. Të rriturit duhet ta lexojnë jo vetëm përvete, por në një bashkëbisedim prindëror e të këndshëm me fëmijët e tyre. Është një himn i bukurisë së librit dhe i fuqisë së leximit që, si një farë pasi mbillet ka nevojë përpërkujdesje, përkushtim dhe dashuri në mënyrë që t'i japë frytet dhe të krijojë sa më shumë lexues.

"Kopshtari i ëndrrave" është një tekst i bërë me fjalë delikate dhe muzikale që mund të lexohet fare mirë me zë të lartë, me imazhe poetike me ngjyrë pasteli. Një histori që ka shijen e një përralle, "historia e të gjitha historive" që përçohet qysh në kopertinë, ku duket një burrë me përparrëse që e ka futur kokën brenda fletëve-gjethje dhe, qysh në titull në mënyrë kuptimplotë librit i krahason me ëndrrat.

Shkrimtari CLAUDIO GOBBETTI, në vitin 2022 është nderuar me çmimin e madh "Andersen" - Baia delle Favole, një çmim që kanë krijuesit me emër botërorë, si: Italo Calvino, Alberto Moravia, De Filippo etj.

Ardhja e librit "Kopshtari i ëndrrave", i munguar në bibliotekën shqipe, nga Sh. B. Mediaprint është një akt fisnik e kulturor, ku vlera e librit ka dimensione planeti. Në fakt, kjo Shtëpi Botuese, në zgjedhjet e saj ka shije, cilësi, kulturë e edukim të librave të përkthyer që kanë bërë emër në botë. Ato kanë pasuruar e drithësuar letrat shqipe, dhe e ka përbalur atë me modele letrare. Me këtë libër plot ëndrra, duhet të nis krijuimi i çdo bibliotekë fëmijësh e të rriturish. Nuk mund të lë pa përmendor punën magjike të përkthyeshes Arta Marku. Përse e them: 'magjike'? Sepse i tillë është ky libër, dhe përkthyeshja ruajti testamentin e shpirtit të tij: Kopshtari dhe ëndrrat e tij të përbotshme!



NUMRI I ARDHSHËM MË 5 GUSHT

HEJZA

20 KORRIK, 2023

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**
Drejtor: **Genc Halimi** (genc@takat.tv)

Rruga e Kaçanikut nr. 208, Shkup, 1000